



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

## 2022

Prishtinë, prill 2023

## PËRMBAJTJA

FJALORI I SHPREHJEVE .....	4
FJALA E AUDITORES SË PËRGJITHSHME .....	6
VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT .....	8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	9

## Kapitulli I

Kapitull I Korniza ligjore dhe Qeverisja e Brendshme .....	17
1 Pavarësia dhe Korniza ligjore .....	17
1.1 Pavarësia institucionale .....	17
1.2 Mandati .....	18
Foto 1. Prezantimi në Kuvend i raportit vjetor të auditimit për vitin 2021.....	18
2 Qeverisja e brendshme dhe etika .....	19
2.1 Planifikimi strategjik dhe operativ.....	19
2.2 Mjedisi i kontrollit organizativ.....	20
2.3 Komunikimi i brendshëm .....	21

## Kapitulli II

Kapitulli II - Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi .....	25
1 Cilësia e auditimit dhe raportimi.....	25
2 Auditimet e realizuara dhe të planifikuara .....	27
3 Rezultatet dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit (financiar dhe të pajtueshmërisë).....	30
4 Auditimet e performancës.....	34
5 Kontrolli i cilësisë .....	40

## Kapitulli III

Menaxhimi Financiar dhe Administrativ .....	43
Kapitulli III - Menaxhimi Financiar dhe Administrativ .....	45

1 Menaxhimi financiar .....	45
2 Burimet Njerëzore .....	49
4 Shërbimet e përbashkëta .....	53
5 Teknologjia informative .....	53
6 Prokurimi.....	54

## Kapitulli IV

Kapitulli IV - Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e jashtme .....	57
1 Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit.....	57
2 Komunikimi me mediat, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe palë të tjera .....	60
3 Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere dhe Marrëveshjet Bilaterale .....	64

## Kapitulli V

Kapitulli V – Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2023 .....	71
1 Llogaridhënia e ZKA-së .....	71
2 Aktivitetet gjatë vitit 2023.....	71
Shtojca I. AUDITIMET PËR SEZONIN 2021/22 DHE 2022/23 .....	73
Shtojca II. PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZKA-SË PËR VITIN 2022.....	78

## FJALORI I SHPREHJEVE

AB	Auditori i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA)
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KIDP	Korniza e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale
KBPT	Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
NP	Ndërmarrje Publike
OB	Organizata Buxhetore
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore RVPR
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
RFV/BK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
NAO	Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SITA	Sistemin Informativ i Teknologjisë së Auditimit
TI	Teknologjia Informative
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit



## FJALA E AUDITORES SË PËRGJITHSHME



Raporti Vjetor i Performancës për vitin 2022 është përgatitur dhe dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (nenit 138), dhe Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (nenit 14).

Ky raport përmbledh rezultatet që Zyra Kombëtare e Auditimit ka arritur gjatë vitit 2022 dhe shpalos nivelin e performancës së përgjithshme të këtij Institucioni karshi detyrimeve dhe mandatit ligjor që ka. Raporti përqendrohet në mënyrën se si janë shfrytëzuar burimet që më janë besuar janë besuar për kryerjen e proceseve audituese. Gjithashtu,

reflekton progresin e treguar krahasuar me vitet e mëparshme dhe tregon planet tona të mëtejme për të adresuar sfidat më të cilat ballafaqohemi.

Aktiviteti auditues është mbështetur në Planin Vjetor të Auditimit 2021/22, që paraprakisht i është dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2022, përveç auditimeve të detyrueshme të rregullsisë, fokus i veçantë i është dhënë auditimeve të performancës në interes të qytetarëve dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Angazhimi i ZKA-së, gjatë këtij viti është përqendruar gjithashtu në auditimet e institucioneve publike dhe ndërmarrjeve publike të cilat nuk ishin audituar një kohë të gjatë nga auditimi shtetërorë siç janë: KEK, KOSTT, RTK dhe projekte kapitale me peshë të lartë financiare. Po ashtu, marrë parasysh zhvillimin e hovshëm në fushën e teknologjisë së informacionit dhe nevojës për sigurinë e sistemeve të TI-së, ZKA ka audituar sisteme të teknologjisë së informacionit me rëndësi shtetërore dhe strategjike.

Për përmirësimin e menaxhimit të financave publike, dhe shfrytëzimin e fondeve publike me efikasitet, efektivitet dhe arritjen e vlerës për para në vitin 2022 (që mbulojnë periudhën 2021) kemi dhënë 1,030 rekomandime.

Është rritur efikasiteti dhe ruajtur konsistenca në auditim duke avancuar tutje metodologjinë e punës në funksion të digjitalizimit të procesit auditues. Bashkëpunimi me palët e interesit, posaçërisht me shoqëritë civile dhe qytetarët është avancuar, me qëllim të gjithëpërfshirjes dhe rritjes së transparencës lidhur me menaxhimin e parasë publike. Gjatë vitit 2022, kemi dërguar 77 raste me elemente potenciale të veprave penale, mashtrimit dhe korrupsionit në Prokurori të Shtetit, si dhe kemi ofruar informacione të kësaj natyre për organet e hetuesisë.

Gjatë vitit 2022, ZKA-ja është anëtarësuar në grupe të ndryshme profesionale në kuadër të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, dhe stafi i zyrës ka marrë pjesë dhe ka përfaqësuar institucionin në nivel rajonal dhe ndërkombëtarë.

I jam mirënjohëse bashkëpunimit konstruktiv me Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkatësisht (KMFB) për shqyrtimin e raporteve të auditimit dhe (KBPT) dhe mbështetjen e dhënë për të përmbushur objektivat e mia. Përmbushja e Planit vjetor të auditimit për 2022 dhe rezultatet e arritura, i atribuohet i gjithë stafit për punën e palodhur dhe përkushtimin në kryerjen e detyrave me profesionalizëm të lartë.

Fuqishëm e theksoj përkushtimin tim, që ta avancoj më tutje kompetencën profesionale të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ruaj pavarësinë institucionale, forcojë integritetin, transparencën dhe frymën ekipore me qëllimin e vetëm që t'i ofrojë Kuvendit dhe qytetarëve informacion objektiv dhe relevant për shpenzimin e parasë publike.

Me respekt,

**Vlora Spanca**

**Auditore e Përgjithshme**

**Prishtinë, 2023**

## VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT



### Vizioni

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.



### Misioni

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe rritjen e llogaridhënies publike.

## Vlerat e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

### Pavarësia

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.



### Transparenca

ZKA është organizatë e hapur dhe do t'i bëj publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofroj publikut të gjerë informacionin e përftuar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA angazhohet që të promovoj transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

### Profesionalizmi

ZKA udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të ONISA/INTOSAI dhe nga praktikat e mira të vendeve tjera



### Integriteti

ZKA angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.



### Fryma ekipore


Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunues në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2022, Zyra e Kombëtare e Auditimit ka vazhduar angazhimet për të përmbushur në përgjithësi kërkesat kushtetuese dhe ligjore në auditimin e të gjitha organizatave buxhetore, ndërmarrjeve publike dhe auditime të tjera të performancës dhe pajtueshmërisë. Në këtë vit janë kryer dhe publikuar gjithsejtë 127 raporte të auditimit të fushave financiare/pajtueshmërisë, si dhe të performancës. Po ashtu është kryer monitorimi i zbatimit të rekomandimeve, si dhe proceset e administrimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe burimeve njerëzore. Duhet theksuar se vëmendja i është kushtuar edhe komunikimit të brendshëm dhe palëve të jashtme të interesit. Informacione të hollësishme janë të shpalosura në brendi të këtij raporti.

### Rezultatet e punës audituese për vitin 2022



#### Auditimet Financiare dhe të Pajtueshmërisë

Për vitin 2022 janë kryer 116 auditime dhe janë publikuar raportet përkatëse, të cilat përfshijnë:


Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2021,

**90** raporte për Organizatat Buxhetore,

**12** raportetë auditimit për Ndërmarrjet Publike, dhe

**13** raporte të auditimit të projekteve (financuara nga donatorët-BB).

#### Auditimet e performancës



**10** auditime të performancës.

Auditimet e performancës kanë mbuluar fushat, si: arsimi dhe sporti, zhvillimi ekonomik, shëndetësia, ujërat dhe mjedisi, teknologjia e informacionit si dhe fusha e prokurimit publik.

#### Auditimet e veçanta të pajtueshmërisë

**1** raport me Informata të klasifikuara „E KUFIZUAR”.


## Rezultatet Kryesore nga Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2021.

Në auditimet e kryera gjatë vitit 2022 janë nxjerrë në pah një numër dobësish në shumicën e organizatave buxhetore dhe entitete tjera nëpër kategori ekonomike, të cilat kanë rezultuar në menaxhim të dobët të fondeve buxhetore si dhe mos arritjen e vlerës për para.

Dobësitë kryesore të identifikuara gjatë këtyre auditimeve janë theksuar tek kategoritë ekonomike, si: Të Hyrat, Pagat, Mallrat dhe Shërbimet, Subvencionet dhe Transfere, Investimet kapitale, dhe Pasuritë. Për çështjet e prezantuara në RVA janë dhënë rekomandime përkatëse.


### Zbatimi i rekomandimeve

Zbatimi i rekomandimeve për Organizatat Buxhetore për vitin 2020



ZKA, në raportet e auditimit për PVF-të e vitit 2020 kishte dhënë 654 rekomandime (institucione qendrore, të pavarura dhe lokale). Gjatë auditimit në vitin 2021 kishte vlerësuar zbatimin e rekomandimeve. Sipas këtij vlerësimi në 50% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 5% ishin zbatuar pjesërisht dhe 45% nuk janë zbatuar.

Zbatimi i rekomandimeve për Ndërmarrjet Publike për vitin 2020



Në NP, numri i rekomandimeve të dhëna për PVF-te e vitit 2020 ishte 152 sosh dhe gjatë vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve në vitin 2021, mbi 53% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 4% janë në proces të zbatimit, dhe 43% nuk janë zbatuar.

## Menaxhimi financiar dhe administrativ i ZKA-së, për vitin 2022

Buxheti final i ZKA-së ishte 3,046,355€, ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 2,785,368€, apo 91%. Buxheti ishte i ndarë në katër kategori ekonomike, si:

- Paga dhe shtesa

**2,291,035€**

- Mallrave dhe Shërbimeve


**685,320€**

- Shërbimeve komunale

**40,000€**

- Investimeve kapitale

**30,000€**



ZKA në fund të vitit 2022 kishte 166 punonjës. Struktura e numrit të përgjithshëm të personelit përbëhet prej 83% personel auditues (përfshirë pozitat drejtuese), dhe 17% janë punonjës të shërbimeve profesionale mbështetëse. ZKA, ka investuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit auditues për të siguruar që ata të jenë në hap me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e financave, auditimit dhe fushave tjera relevante.

Në këtë vit kemi adresuar në Kuvend dhe Qeveri të Republikës së Kosovës, iniciimin e procesit për plotësim – ndryshimin e Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Gjithashtu, është bërë rishikimi i Kodit të Etikës, i cili është në harmoni të plotë me Kodin e Etikës të INTOSAI-t. Kodi është rishikuar për të siguruar se përmbajtja e tij është në përputhje me përditësimet e reja globale.

Kontrollet e brendshme dhe komunikimi i brendshëm në organizatë janë avancuar më tej.

Bashkëpunimi me organet e sundimit të ligjit, gjatë këtij viti ka rezultuar me dërgimin e 77 rasteve me elemente potenciale të veprave penale, mashtrimit dhe korrupsionit në Prokurori të Shtetit.

## Komunikimi me palët e jashtme



ZKA në vitin 2022 ka zhvilluar komunikim të frytshëm me palët e ndryshme të interesit, si dhe aktivisht ka qenë pjesëmarrëse në shumë takime, punëtori e konferenca brenda dhe jashtë vendit.

Në aspektin vendor është forcuar më tej partneriteti me komisionet parlamentare dhe organizatat e

shoqërisë civile. Kurse në aspektin ndërkombëtar është avancuar bashkëpunimi me Institucionet Supreme të Auditimit përmes takimeve, punëtorive e aktiviteteve të tjera në kuadër të EUROSAT-t dhe INTOSAI-t, si dhe në nivel regional në kuadër të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve candidate dhe candidate të mundshme për anëtarësim në BE. Ndër ngjarjet kryesore më interes të lartë për ZKA-në janë:

- Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës, është intensifikuar kryesisht përmes punës me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere (KBPT). Gjatë vitit 2022 Kuvendi ka shqyrtuar 25 raporte të auditimit, për të cilët ka dhënë edhe rekomandime për përmirësim për Institucionet e audituara,
- Anëtarësimi i ZKA-së në Grupin Punues për Teknologji të Informacionit në EUROSAI,
- Forcimi i bashkëpunimit me UN Women,
- Bashkëpunimi i ISA-ve në nivel shtetesh për auditimet e agjendës së Qëllimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm,
- Zhvillimi i auditimeve paralele në fushën e teknologjisë së informacionit ndërmjet ZKA-së dhe KLSH-së,
- Përfshirje në ngjarje të ndryshme të organizuara nga EUROSAI,
- ZKA dhe USAID-i, kanë nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit për zbatimin e Projektit “Aktiviteti për Integritet të Komunave të Kosovës”,
- ZKA, ka nënshkruar memorandum të bashkëpunimit me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik,
- Është nënshkruar gjithashtu, Marrëveshja e bashkëpunimit midis ZKA-së dhe MFPT-së – Thesarit për transferimin automatik të të dhënave.

**Vlerësimet për ZKA-në nga palët e jashtme për vitin 2022** - ZKA është vlerësuar më e besuara ndër institucionet e auditimit në rajon sipas Barometrit Ballkanik për vitin 2022. Afërsisht tri të katërtat apo 74% e të anketuarve janë shprehur se i besojnë këtij institucioni krahasuar me 36% sa ka qenë në vitin 2020 sipas këtij Barometri. Ky është niveli më i lartë i besueshmërisë krahasuar me institucionet supreme të auditimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Poashtu, të dhënat e Barometrit Ballkanik, tregojnë se 67% e qytetarëve të Republikës së Kosovës e perceptojnë ZKA-në si institucion të pavarur nga ndikimi politik për dallim nga 32% sa ishte në vitin 2020. Barometri i Ballkanit ka vlerësuar perceptimin e qytetarëve në aspektin se sa ZKA ka shqyrtuar punën e Qeverisë për ta mbajtur atë përgjegjëse para qytetarëve. Kosova kryeson edhe në këtë aspekt: 68% e të anketuarve (22% më shumë se në 2020) mendojnë se ZKA-ja është në gjendje të shqyrtojë punën e qeverisë”.

Raporti i Progresit për Kosovën për 2022, gjithashtu, ka vlerësuar lartë edhe bashkëpunimi i ZKA-së me Kuvendin e Kosovës, përkatësisht shqyrtimi i raporteve të auditimit dhe rritja e numrit të auditimeve të performancës, bashkëpunimi me shoqërinë civile, si dhe qëndrueshmëria e ZKA-së sa i përket kapacitetit të resurseve njerëzore.


## Baza e Raportit të Performancës

Mbështetur në nenin 14 të ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i dorëzon Kuvendit Raportin Vjetor të Performancës rreth aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Ushtrimi i mandatit kushtetues dhe ligjor i ZKA-së, bazohet në strukturën e Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA). Kjo kornizë u ofron ISA-ve mundësinë që të vlerësojnë nivelin e performancës së tyre kundrejt Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Kjo kornizë ka për qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm në zhvillimin e kapaciteteve të ISA-ve përmes menaxhimit dhe promovimit të matjes së performancës, si dhe identifikimin e mundësive për të forcuar dhe monitoruar performancën dhe llogaridhënien e ISA-ve.


Korniza e Matjes së Performancës së ISA-ve, si dokument standard i INTOSA-it, përmban gjashtë fusha kryesore:




# 1

## Kapitulli

Korniza ligjore dhe Qeverisja e Brendshme







## Kapitull I - Korniza ligjore dhe Qeverisja e Brendshme

Pavarësia dhe qeverisja e brendshme në mënyrë të drejtpërdrejtë reflektojnë përmbushjen e mandatit kushtetues e ligjor me qëllim të kryerjes së auditimeve cilësore në përputhje me SNISA.

### 1 Pavarësia dhe Korniza ligjore

Kjo fushë mbulon mandatin ligjor dhe pavarësinë e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm (AP)<sup>1</sup>. Përveç kornizës ligjore të vendit, Kushtetutës dhe ligjeve relevante, bazë e parimeve themelore të ISA-ve për këtë fushë janë: Deklarata e Limës (INTOSAI-P 1) dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve (INTOSAI-P 10). Elementet tregues që ZKA-ja ka aplikuar për këtë fushë janë: pavarësia institucionale dhe mandati.

#### 1.1 Pavarësia institucionale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton se Auditori i Përgjithshëm është institucioni më i lartë i pavarur i kontrollit ekonomik e financiar në vend. Kompetencat themelore të AP-së janë përcaktuar me Kushtetutë dhe janë definuar më tej me ligjin e veçantë, Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (Ligji i ZKA-së), i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2016. Sipas legjislacionit në fuqi, AP-ja ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij. Ai është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së.

Gjatë vitit 2022, nuk janë shënuar raste të ndonjë ndërhyrjeje nga palët e treta në punën e ZKA-së dhe AP-së ka ushtruar e lirë dhe e pa ndikuar rolin dhe veprimtarinë të përcaktuar me kushtetutë dhe me ligj.

Ndër parimet bazë të funksionimit të Auditorit të Përgjithshëm janë kushtetutshmëria dhe ligjshmëria. Për zbatimin e këtyre parimeve, është materializuar pavarësia kushtetuese e Auditorit të Përgjithshëm përmes kornizës së brendshme normative, e cila ka marrë dimensione të reja në vitin 2021. Në fakt, Auditori i Përgjithshëm i ka dhënë theks të ri kësaj kornize duke aprovuar strukturën e re organizative.

Në anën tjetër, edhe Ligji aktual për ZKA-në ka nevojë për ndryshim/ plotësim. Në lidhje me këtë, AP-ja i ka informuar edhe deputetët e Kuvendit edhe anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe ata të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Një ndryshim tjetër i rëndësishëm i këtij ligji ka të bëjë me heqjen e obligimit për auditime të përvitshme të rregullsisë, për të gjitha organizatat buxhetore i cili pamundëson aplikimin e qasjes së përzgjedhjes së auditimeve bazuar në rrezik. Ky ndryshim do ti hapte rrugë zgjerimit më të madh të auditimeve të pajtueshmërisë dhe performancës. Në lidhje me këtë ka parashtruar kërkesë zyrtare për nevojën që ka ZKA për një rregullim të ri ligjor.

1. Në këtë Raport, institucionit të Auditorit të Përgjithshëm do t'i referohemi edhe si Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

## 1.2 Mandati

Ky Tregues vlerëson autoritetin operacional të ZKA-së, të përcaktuar në Kornizën ligjore. Dimensionet për të vlerësuar këtë tregues janë: mandati i mjaftueshëm dhe i gjerë; qasja në informata; dhe e drejta dhe detyrimi për të raportuar.

Kushtetuta e vendit dhe Ligji i veçantë, i japin AP-së **mandat të gjerë të auditimit** të të gjitha subjekteve të sektorit publik në Kosovë. Megjithatë, disa ligje të veçanta kanë krijuar paqartësi për auditimin e disa institucioneve publike që çështjen e auditimit e kanë trajtuar në mënyrë tjetër krahasuar me dispozitat kushtetuese dhe ato të Ligjit për AP-në<sup>2</sup>. Për më tepër, Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk është harmonizuar me Kushtetutën, Ligjin për AP-në dhe Ligjin për Ndërmarrjet publike (NP), lidhur me mandatin e AP-së për auditimin e NP-ve dhe afatet kohore për raportim financiar.

AP-ja, në përputhje me autorizimet kushtetuese e ligjor, ka qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit. Gjatë periudhës raportuese, bashkëpunimi me subjektet e audituara ka qenë korrekt dhe nuk është shënuar ndonjë rast i kufizimit të qasjes për auditorët. Zyrtarëve të autorizuar nga AP-ja u është mundësuar që në çdo kohë të arsyeshme të hyjnë dhe të qëndrojnë në objektet e organizatave buxhetore të audituara.

AP-ja e ka autoritetin kushtetues që në mënyrë të pavarur të raportojë në Kuvend gjetjet e çdo viti. Në tetor të 2021, AP-ja ka prezantuar para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin Vjetor të Auditimit për vitin fiskal 2021. Mbi këtë bazë, AP-ja ka ftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës që të kërkojë rritjen e përgjegjësisë llogaridhënëse nga institucionet e audituara në mënyrë që të ndërmarrin veprime të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve dhe adresimin e mangësive të raportuara. Sikurse edhe gjatë viteve paraprake, ZKA-ja i ka bërë publike të gjitha raportet e auditimit.

### Foto 1. Prezantimi në Kuvend i raportit vjetor të auditimit për vitin 2021



2. BQK – Banka Qendrore e Kosovës; AKI – Agjencia Kosovare e Inteligjencës, dhe FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

## 2 Qeverisja e brendshme dhe etika

Qeverisja e brendshme dhe etika, përfshinë treguesit si, plani strategjik dhe operativ, mjedisi i kontrollit organizativ dhe komunikimi i brendshëm.

### 2.1 Planifikimi strategjik dhe operativ

ZKA-ja zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në planin strategjik trevjeçar, planin operativ dhe planin vjetor të auditimit.

**Planifikimi Strategjik-** gjatë kësaj periudhe kohore është punuar në hartimin e Planit të ri Strategjik 2023-2026. Plani i ri strategjik përmban 3 qëllime strategjike dhe 22 objektiva strategjike, pra për këtë periudhë kohore ZKA ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për arritjen e qëllimeve strategjike, si: përmbushjen e misionit kushtetues e ligjor, duke kryer auditime relevante në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit; zhvillimin e kapaciteteve institucionale; si dhe zhvillimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira me palët e jashtme.

Auditorja e Përgjithshme ka vlerësuar se është e rëndësishme që ZKA-ja t'i nënshtrohet vlerësimit të performancës sipas Kornizës së INTOSAI-t për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA), dhe në tetor 2021, ka marrë vendimin për të kryer vetëvlerësimin e performancës së institucionit sipas kësaj kornize. Mbi këtë bazë gjatë vitit 2022 është punuar nga ekipi përkatës dhe procesi i vlerësimit është në finalizim, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të zyrtarëve të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t. Me finalizimin si proces, rezultatet e dalura nga vlerësimi do i shërbejnë Auditorës së Përgjithshme për planifikimet e ardhshme të ndërmerrën masa përmirësueses/avancuese, me qëllim të rritjes së ndikimit të rezultateve të auditimit si dhe zhvillimit të kapaciteteve të ZKA-së.

**Plani operativ vjetor** – ZKA ka vazhduar edhe këtë vit fiskal me përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe afateve ligjore në kryerjen e auditimeve.

Duhet të theksohet se përputhje me planin vjetor janë bërë **përpyjekje** maksimale nga stafi auditues dhe jo auditues që gjitha auditimet e planifikuara për vitin 2022 të përfundohen me kohe, gjë që kjo objektiv është arritur me efikasitete dhe efektivitet maksimal.

**Plani vjetor i auditimit-** AP-ja ka miratuar Planin Vjetor të Auditimit 2022/23, i cili përfshinë sezonin auditues për periudhën 1 shtator 2022 deri më 31 gusht 2023.

ZKA harton për çdo vit planin vjetor të auditimit, i cili përmban informata për objektivat e ZKA-së, llojet e auditimeve, procesin e auditimit, organizimin, buxhetin dhe burimet njerëzore, dhe auditimet e projekteve.

Gjatë hartimit të Planit vjetor janë marrë në konsideratë përmbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës, ku si kriter është vlerësuar rëndësia dhe aktualiteti i çështjeve të caktuara. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe kapacitetet njerëzore dhe financiare që ka pasur në dispozicion ZKA-ja. Plani i është dorëzuar KMFP-së për informim në fillim të sezonit auditues në përputhje me kërkesat ligjore.

## 2.2 Mjedisi i kontrollit organizativ

Bazuar në kërkesat që burojnë nga ligji, rregulloret e brendshme dhe SNISA-të, si dhe për të përmbushur misionin që ka ZKA-ja, është miratuar struktura organizative e cila është në funksion të krijimit të një sistemi të kontrollit të brendshëm që ofron siguri të arsyeshme se operacionet e institucionit menaxhohen në mënyrë efikase dhe efektive, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi

**Kodi i ri Etikës** – është në harmoni të plotë me Kodin e Etikës të INTOSAI. Kodi është rishikuar në vitin 2022 për tu siguruar se përmbajtja e tij është në përputhje me përditësimet e reja. Në këtë kod të aprovuar nga AP-ja janë rregulluar çështja e integritetit, pavarësisë, objektivitetit, kompetencës profesionale, konfidencialitetit, konfliktin e interesit. Kodi zbatohet për të gjithë punonjësit e ZKA-së.

ZKA ka hartuar procedura të shkruara, të cilat ndër tjera kërkojnë që i gjithë personeli dhe palët e autorizuar për të kryer punë për ZKA-në, të pajtohen me kërkesat etike, duke nënshkruar dhe respektuar **Kodin e Etikës** dhe **Deklaratën e pavarësisë profesionale**. Mbi këtë bazë është themeluar edhe Komisioni për çështje etike, i cili përcjell zbatimin e Kodit të etikës dhe jep konkluzione për çdo rast/ kërkesë nga stafi lidhur me çështjet etike.

**Sistemi i kontrollit të brendshëm**- Kontrolli i brendshëm për aktivitetet jo audituese kryhet nëpërmjet rregullave dhe procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në ZKA zbatohen: ndarja e detyrave, delegimi, autorizimi, mbikëqyrja dhe auditimi i brendshëm.

ZKA-ja ka hartuar edhe dokumentin për menaxhimin e rreziqeve, i cili zbatohet duke u bazuar në objektivat e vendosura me dokumentet strategjike të ZKA-sëajë dhe kornizën tjetër të aplikueshme për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK). Për më tepër, ZKA-ja ka të dizajnuar një strukturë funksionale të kontrolleve të brendshme. Të gjitha komponentët e kontrolleve operojnë në mënyrë efektive, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve.

**Auditimi i brendshëm**- ZKA ka një auditor të brendshëm (AB) që i raporton drejtpërdrejtë AP-së. Metodologjia e bazuar në rrezik përdoret për planifikim të auditimit me qëllim që ti ofrohet siguri AP-së se proceset e menaxhimit të rrezikut, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm në ZKA funksionojnë në mënyrë efektive.

Gjatë vitit 2022, AB i ka dorëzuar AP-së pesë (5) raporte të auditimit, në temat lidhur me: Proceset e prokurimit, Procesi i rekrutimit në ZKA, Menaxhimi i shpenzimeve dhe Procesi i buxhetimit në ZKA, Procesi i rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa" dhe Aranzhimet e Qeverisjes në ZKA

Është i themeluar edhe Komiteti i Auditimit (KA), i cili kryen funksionin e tij në përputhje me rregullativen në fuqi. Me qëllim të mbështetjes së AP-së si dhe përmirësimit të qeverisjes në ZKA, KA gjatë vitit 2022 ka mbajtur katër takime në të cilat janë shqyrtuar raportet e AB-së dhe opinioni i auditorit të jashtëm për PF-vjetore.

### **2.3 Komunikimi i brendshëm**

Komunikimi efektiv i brendshëm i mundëson punonjësve të ZKA-së në gjitha nivelet ti kordinojnë kërkesat dhe propozimet të ndryshme për çështjet që lidhen me punën audituese, si dhe për çështje administrative brenda institucionit.

Menaxhmenti i ZKA-së mban takime të rregullta javore, të dokumentuara me procesverbale. Vendimet kryesore dokumentohen dhe i komunikohen stafit. Këto dokumente janë të qasshme për të gjitha nivelet organizative. Ekziston mekanizëm për shpërndarjen e informacionit tek stafi nëpërmjet një rrjeti të brendshëm të komunikimit elektronik, përmes së cilit menaxhmenti i ZKA-së i informon rregullisht punonjësit mbi çështjet kryesore të lidhura me organizatën


Puna audituese dokumentohet dhe raportohet përmes organizimit dhe mirëmbajtjes së dosjeve përkatëse dhe sistemit elektronik SITA, i cili ka rezultuar me rritjen e transparencës dhe kontrollin e cilësisë në kryerjen e funksionit auditues.




# 2

## Kapitulli

Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi







## Kapitulli II - Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi

Fushëveprimi/cilësia e auditimeve, raportimin e rezultateve të auditimeve, adresimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara, si dhe kontrollin e cilësisë janë komponentët që trajtohen në këtë kapitull.

### 1 Cilësia e auditimit dhe raportimi

ZKA-ja kryen auditimet në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe praktikave të mira. Po ashtu, për të siguruar cilësinë e auditimeve ka të hartuar doracakët e auditimit financiar me qasje të kombinuar me pajtueshmëri, doracakun për auditime të performancës dhe prokurimit si dhe doracakun për auditime të teknologjisë së informacionit. Për të siguruar se cikli i llogaridhënies lidhur me cilësinë në auditim përmbillet siç duhet, ka të hartuar edhe udhëzuesin për menaxhimin e cilësisë në auditim. Në bazë të ligjit të ZKA-së, të gjitha raportet e auditimit bëhen publike në web-faqen zyrtare.

Në përputhje me mandatin ligjor dhe fushëveprimin, ZKA kryen këto lloje të auditimeve:

- ❖ Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë të organizatave buxhetore (bazuar në sistemin e parasë së gatshme) dhe të ndërmarrjeve publike (bazuar në sistemin akrual); dhe
- ❖ Auditime të performancës, përfshirë auditimet e teknologjisë së informacionit.

**Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë** - përfshijnë auditimin e PFV-ve të institucionit me qëllim të vlerësimit nëse raportet financiare janë të besueshme dhe pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.

Objektivat e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë përkufizohen si siguri e arsyeshme, e cila i ofrohet shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, nëse informatat në pasqyrat financiare të audituara janë në tërë kuptimin material të vërteta dhe të drejta dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet<sup>3</sup>.

Sipas SNISA-ve të përditësuara, auditimet e rregullsisë së PVF-ve janë auditime financiare dhe auditime të pajtueshmërisë (qasje e kombinuar), prandaj në vazhdim po japim përkufizimet për objektivat e llojeve të auditimeve.

3. "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë përputhshmëri me aktet apo rezolutat e legjislaturës apo instrumente tjera statutore, direktiva dhe udhëzues të nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të përcaktuara me statut, të cilave pritet t'i përmbahet entiteti i audituara. Thënë ndryshe, është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira.

- ❖ Objektivi i **auditimit financiar** të pasqyrave financiare është të rrisë nivelin e besimit tek përdoruesit e pasqyrave financiare. Kjo arrihet përmes dhënies së opinionit nga ana e auditorit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën raportuese në fuqi; si dhe të ofrojë siguri të arsyeshme se informacioni financiar në raportin vjetor financiar është i vërtetë, i drejtë dhe konsistent me Kornizën për raportim financiar dhe Kornizën rregullative.
- ❖ Objektivi i **auditimit të pajtueshmërisë** është që të informojë përdoruesit nëse entitetet publike të audituara respektojnë vendimet e Kuvendit, ligjet, aktet legislative, politikat, kodet, praktikat e mira, si dhe të ofrojë siguri se proceset raportuese të kontabilitetit/financiare dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me autoritetet.

Qëllimi gjithëpërfshirës i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë është të rritet niveli i besueshmërisë së përdoruesve të synuar të Pasqyrave Financiare dhe përdorimi i fondeve publike në pajtueshmëri me autoritetet.

Auditimet financiare dhe pajtueshmërisë kryhen çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti vjetor i auditimit (RVA) për Raportin financiar vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

**Auditimet e performancës-** paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (minimizimi i kostove të burimeve), efikasitetit (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe efektivitetit (përbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara). Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek një rën nga tri qasjet: qasjen e orientuar në rezultate, qasjen e orientuar në problem dhe qasjen e orientuar në sistem, ose një kombinim të të tri qasjeve.

Auditimet e teknologjisë së informacionit (TI)- pasqyrojnë vlerësimin dhe rishikimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrollet e ndërlidhura me to, për të përfituar siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së.

## 2 Auditimet e realizuara dhe të planifikuara

ZKA-ja ka kryer dhe publikuar 127 raporte të auditimi gjatë vitit 2022, si në vijim:

### 116 Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)

- ✓ Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2021,
- ✓ 90 raporte për organizatat buxhetore,
- ✓ 12 raporte të auditimit për Ndërmarrjet Publike, dhe
- ✓ 13 raporte të auditimit të projekteve (financuara nga donatorët).

### 10 raporte të auditimit të performancës<sup>4</sup>

- ✓ 10 raporte të auditimit të performancës (për fusha të ndryshme si: shëndetësia, investimet publike dhe infrastrukturë, prokurimi publik, mjedisi dhe teknologjia e informacionit).

### 1 raporte të pajtueshmërisë<sup>5</sup>

- 1 raport me Informata të klasifikuara „E KUFIZUAR”- (Ministria e Mbrojtjes).

Në Planin Vjetor për sezonin e auditimit 2022/23, ZKA-ja planifikon të kryejë dhe të publikojë 134 auditime, si në vijim:

### 113 Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)

- ✓ Auditimin e Raportit Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2022,
- ✓ 90 organizata buxhetore (52 institucione të nivelit qendror dhe 38 të nivelit lokal)<sup>6</sup>
- ✓ 11 Ndërmarrje Publike, dhe
- ✓ 11 auditime të projekteve (financuara nga donatorët).

5. Sqarim: Këto 10 raporte janë kryer dhe publikuar gjatë viti 2022, ndërsa me planin e auditimit 2021/2022 janë planifikuar 15 auditime performancës të cilat janë kryer të gjitha brenda sezonit 2021/2022. Pra 5 raporte që janë kryer në vitin 2021 janë: Vendimet lidhur me strukturën organizative Alpex-KOSTT, Granti i performancës komunale-Demos, Menaxhimi i medikamenteve dhe materialeve shëndetësore, Organizimi i resurseve njerëzore dhe teknike -Covid 19, dhe Shërbimet e transportit ajror.

6. Një auditim me informatat e klasifikuara (MM), ndërsa me planin e auditimit 2021/2022 është planifikuar edhe auditimi i pajtueshmërisë „Dhënia e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronës dhe marrëveshja për shfrytëzim të energjisë KOSTT” i cili është kryer dhe publikuar në vitin 2021.

7. ZKA-ja ka angazhuar një kompani private të auditimit, e cila do të përkrahë auditimin e 11 Institucioneve të Pavarura dhe 6 komunave. Megjithatë, sigurimi i cilësisë së raporteve dhe dhënia e opinionit të auditimit do të bëhet nga AP-ja.

## 18 Auditime të performancës

- ✓ 18 auditime të performancës (për fusha të ndryshme si: Shëndetësi, Kulturë, Zhvillimi ekonomik dhe mjedisi, Prokurimi publik dhe TI).

## 3 auditime të pajtueshmërisë

- ✓ 3 auditime të pajtueshmërisë përfshihen (auditimin e hyrave nga qiraja e AKP-së dhe dy auditime për informatat e klasifikuara (MB dhe MD).

ZKA, kryen auditime të informatave të klasifikuara me nivel të “KUFIZUAR” dhe në të ardhmen pritet që auditimet të shtrihen në nivele më të larta të sigurisë. Veprimet e para për zhvillimin e infrastrukturës dhe verifikimin e sigurisë dhe përgatitjen e stafit tashme janë ndërmarre.

Tabela 1. Shpalos numrin e përgjithshëm të auditimeve dhe llojet e auditimeve të paraqitura me një bazë krahasuese për tre (3) sezone/vitet e fundit të auditimit. Të dhënat e raporteve të përfunduara dhe të auditimeve në proces janë paraqitur në **Shtojcën 1** të këtij raporti.

**Tabela 1.** Numri dhe llojet e auditimeve në tri vitet e fundit.

Llojet e auditimeve	Sezoni i auditimit /plani vjetor		
	2022/2023	2021/2022	2020/2021
<b>Auditime të rregullsisë</b>	<b>113</b>	<b>117</b>	<b>116</b>
-Buxheti i Kosovës	1	1	1
-Institucionet Qendrore	52	52	52
-Komunat	38	38	38
-Ndërmarrjet Publike	11	12	12
-Projekte	11	14	13
<b>Auditimet e Performancës</b>	<b>18</b>	<b>15</b>	<b>8</b>
-Përformancë dhe Prokurim	14	8	5
-Teknologji Informative	4	3	3
-Auditime të pa përfunduara nga viti paraprak.	-	4	-
<b>-Auditime të Pajtueshmërisë</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>0</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>134</b>	<b>134</b>	<b>124</b>

Nëse krahasojmë numrin e auditimeve të vitit 2020 me 2023, të paraqitur në tabelën dhe grafikun 1, kemi një rritje të numrit të auditimeve nga 124 në 134 sosh, apo 10 auditime me shumë për këtë periudhë kohore. Po ashtu, në vitin 2021 kanë qenë 4 auditime të bartura nga viti paraprak, përderisa në vitin 2022, të gjitha auditimet e planifikuara janë kryer sipas planit.

Për sezonin auditues 2022/23, përveç auditimeve financiare dhe pajtueshmërisë të 90 OB-ve (pa përfshirjen e RVA-së), do të kryhen 11 auditime të NP, si dhe 11 projekteve të financuara nga donatorët. Prej të cilave, 10 projekte të financuara nga Banka Botërore dhe 1 projekt i financuar nga Agjencioni Suedez për Zhvillim (Sida).

Rritja e numrit të auditimeve për këtë sezon auditues 2022/23 vërehet tek auditimet performancës, nga 15 tema audituese në vitin e kaluar, në këtë vit janë 18 tema audituese, duke përfshirë fushat të rëndësishme, si: shëndetësia, ekonomia, mjedisi, kulturë dhe sport, arsim, mirëqenie sociale, investimet publike (prokurimi publik), dhe teknologjia e informacionit.


Për dallim nga sezoni i kaluar, përveç auditimeve të rregullta vjetore dhe performancës, këtë vit është shtrirë fushëveprimi në ndërmarrje publike me rendësi strategjike për shtetin. AP-ja ka vendosur të kryejë auditimin për Korporatën Energjetike të Kosovës. sh.a (KEK) për herë të parë nga ekipet e ZKA-së

Duhet të theksohet se krahasim me vitin e kaluar kemi zvogëluar kontraktimin e auditimeve prej 8-sosh (prej 25 sa ishin, tani janë 17 të kontraktuara). Në këtë sezon auditues 22/23, auditimi i 11 institucioneve të pavarura dhe gjashtë komunave do të përkrahet nga një kompani private e auditimit, përderisa opinioni i auditimit përcaktohet nga Auditori i Përgjithshëm bazuar në metodologjinë e ZKA-së dhe në përputhje me SNISA-t.

Në këtë sezon auditues, janë përfshirë edhe auditimet e pajtueshmërisë me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, MD dhe MB-së, si auditime për informatat e klasifikuara dhe auditimin e hyrave nga qiraja e AKP-së për përudhën kohore 2012-2021.

Vlen të theksohet se ZKA ka krijuar mekanizma të brendshëm në trajtimin e kërkesave të ndryshme që vijn nga palët e jashtme për auditime me kërkesë, dhe si të tilla janë trajtuar në mënyrën efektive.

### Grafiku 1. Numri dhe llojet e auditimeve në tri vitet e fundit.



Në grafikun 1 në raport me vitet paraprake kemi një rritje të numrit të auditimeve për 10- sosh më shumë.

### 3 Rezultatet dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit (financiar dhe të pajtueshmërisë)

Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës të vitit 2021 është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës brenda afatit ligjor në gusht të viti 2022. Auditorja e Përgjithshme ka prezantuar RVA-në në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës.

**Mangësitë kryesore sipas kategorive ekonomike në RVA- ZKA**, ka nxjerr në pah disa mangësi dobësi në shumicën e organizatave buxhetore, të cilat kanë rezultuar në menaxhim të dobët të fondeve buxhetore si dhe mos arritjen e vlerës për para.

**Të Hyrat-** Mos inspektimi i 20% të pronave komunale, vonesa në lëshimin e kushteve ndërtimore dhe lejeve ndërtimore, shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduar, parregullsi në faturimin e tatimit në pronë, vonesa në shqyrtimin e kërkesave për pajisje me leje të ndërtimit dhe leje mjedisore, dhënien me qira të pronave komunale, mangësi në menaxhimin e të hyrave nga taksat për mbeturina, etj.

**Pagat-** Angazhimi i stafit pa procedura të rekrutimit, mungesa e dëshmimeve për vijueshmërinë në punë, ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara, angazhimi i punonjësve shëndetësorë në spitalet rajonale pa procedura, dobësitë në procedurat e rekrutimit të personelit në shërbimin civil, mos zhvillimi i procedurave të rekrutimit përmes SIMBNj-së dhe mos publikimi i informatave rreth procedurave të rekrutimit, pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore, mungesa e planit të rekrutimit dhe pozitave menaxheriale të paplotësuara.

**Mallrat dhe Shërbimet-** Mangësi lidhur me angazhimet me marrëveshje për shërbime të veçanta, pagesa e qirasë për objektin/hapësirën e pashfrytëzuar, vonesa në mbylljen e avanseve, mangësi në procedimin e pagesave, përfshirë vonesat në pagesën e faturave, klasifikim jo adekuat i shpenzimeve, vendosja e kriterëve favorizuese në specifikacionin teknik, përdorimi i kontratave jo adekuate, vlera të paqarta dhe tejkalim i pagesave për kontratat publike dhe ato kornizë, parregullsi në procedurat e prokurimit, anashkalim i tyre dhe përzgjedhje e ofertës të papërgjegjshme, zhvillimi i procedurave të prokurimit jashtë planit të prokurimit dhe pa njoftim paraprak në AQP.

**Subvencionet dhe Transferet-** Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare, Subvencionimi, thirrja publike dhe monitorimi i subvencioneve në kundërshtim me rregulloren, Subvencionimi i fermerëve në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në thirrjet publike, subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike, vonesa në arsyetimin e subvencioneve dhe mos raportim nga përfituesit, mangësi në procesin e vlerësimit të subvencioneve, parregullsi në përlllogaritjen e vlerës për kompenzimin e dëmeve për fermerët; Skadimi i periudhës së garancionit bankar tek grantet, përfituesit e pensioneve dhe ndihmave.

**Investimet kapitale** – Pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera, specifikimi teknik jo i qartë/matshëm, vonesat në realizimin e punimeve, Lidhja e kontratës përmes procedurës jo adekuate të prokurimit, Ndarja e tenderëve për punë të njëjta, pranimi i furnizimeve në mungesë të dokumentacionit specifik sipas kantarës, klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, nënshkrimi i kontratës përtej vlerës së parashikuar të buxhetit, Investime publike në parcela të pa shpronësuara, mangësi në procedimin e pagesave dhe vonesa në pagesën e faturave, mungesë dhe mangësi në hartimin e projekteve ekzekutive për ndërtim të rrugëve.

**Pasuritë** - Dobësi tjera të cilat janë vërejtur në nivelin qendror por në numër me të vogël janë: Mangësi në regjistrimin e pasurisë në vijim si dhe mos formimi i komisioneve për vlerësimin e pasurisë, si dhe vonesa në vlerësimin e pasurisë. Auditimit të pasurive tek komunat janë, në 10 komuna, nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes regjistrimit të përgjithshëm të pasurisë dhe raportit të inventarizimit, Në 20 komuna, nuk ka funksionuar sistemi e-pasuria ose të gjitha pasuritë nën 1000 janë vendosur pjesërisht në sistemin e-pasuria, në nëntë komuna ka munguar inventarizimi i pasurisë ose është bërë inventarizim i pjesshëm.

**Tabela 2 - Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të OB-ve**

Subjektet e audituara	2021	2020	2019
Niveli qendror	204	244	263
Niveli lokal	438	367	488
Institucionet e pavarur	53	43	52
<b>Totali</b>	<b>695</b>	<b>654</b>	<b>803</b>

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë për rritje të numrit të rekomandimeve krahasuar me vitin paraprak tek komunat përderisa rritje kemi edhe tek institucionet e pavarura, ndërsa rënie kemi tek institucionet e nivelit qendror.

Konkluzioni i përgjithshëm është se ndikimi i punës së ZKA-së mund të vërehet në fushat si në vijim: zvogëlimi i transaksioneve financiare të parregullta; përmirësimi i gabimeve si rezultat i auditimit; dhe rritja e transparencës për shpenzimin e parasë publike (të gjitha raportet e auditimit janë publikuar dhe raportet e performancës janë prezantuar para publikut dhe palëve të interesit).

**Tabela 3. Progresi i zbatimit të rekomandimeve në vitin 2021 për vitit 2020 nga OB**

Auditimet sipas fushave	Nr.	Rek. Nuk janë aplikueshme <sup>7</sup>	Rek. zbatim	Të zbatuara %		Të adresuara pjesërisht apo në proces %		Të pa zbatuara %	
		Nr.	Nr.	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	237	28	209	123	59%	14	7%	72	34%
Institucionet e pavarura	46	2	44	31	71%	1	2%	12	27%
Institucionet e nivelit lokal	371	8	363	152	42%	15	4%	196	54%
<b>Gjithsej</b>	<b>654</b>	<b>38</b>	<b>616</b>	<b>306</b>	<b>50%</b>	<b>30</b>	<b>5%</b>	<b>280</b>	<b>45%</b>

Nga tabela 3 vërehet se niveli përgjithshëm i zbatimit të rekomandimeve është në masën 50%.

7. Këto rekomandime janë rezultat i fuzionimit të ministrive.



ZKA, në raportet e auditimit të vitit 2020 kishte dhënë 654 rekomandime dhe gjatë auditimit në vitin 2021 kishte vlerësuar zbatimin e rekomandimeve. Sipas këtij vlerësimi, 50% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 5% ishin zbatuar pjesërisht, 34% nuk janë zbatuar.

ZKA, ka audituar 12 Ndërmarrje Publike për vitin fiskal 2021. Rezultatet e numrit dhe përcjelljes dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve për këto NP janë paraqitur më poshtë.

**Tabela 4 - Numri i rekomandimeve të dhëna në NP për vitin 2021**

Subjektet e audituara	Totali i rekomandimeve	Rekomandimet e reja	Rekomandimet e përsëritura	Rekomandimet pjesërisht të përsëritura
<b>Ndërmarrjet Publike</b>	207	144	57	6

Numri i rekomandimeve të dhëna për vitin 2021 është rritur dukshëm në krahasim me vitin 2020, nga 152 në 207 apo për 36%. Kjo kryesisht ka ndodhur për shkak se disa nga ndërmarrje vitin e kaluar janë audituar nga firmat private, të cilat nuk kanë bërë edhe auditim të pajtueshmërisë. Shumica e rekomandimeve janë dhënë për Pasqyra financiare dhe më pak për aspektin e pajtueshmërisë, që do të thotë se raportimi ka nevojë për përmirësime thelbësore.

**Tabela 5. Progresi i zbatimit të rekomandimeve nga Ndërmarrjet Publike të audituara në vitin 2021 për vitin 2020.**

Nr.	Ndërmarrjet Publike të audituara	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pa zbatuara	Të mbyl-lura
1	KRU Hidroregjioni Jugor sh.a	3	3	-	-	0
2	Ndërmarrja publike „Termokos” sh.a	7	3	-	4	0
3	Posta e Kosovës	8	4	1	2	1
4	Ndërmarrja Publike Banesore sh.a	4	3	-	-	1
5	Hekurudhat e Kosovës sh.a	12	5	-	-	7

6	KRM „Hidromorava” sh.a	17	13	-	4	0
7	NPH „Ibër-Lepenc” sh.a	7	6	-	1	0
8	KRU „Uniteti” sh.a	17	12	1	4	0
9	KRU „Prishtina” sh.a	28	5	-	16	7
10	Hekurudhat e Kosovës „TrainKos” sh.a	9	5	-	2	2
11	Telekomi i Kosovës	17	4	3	9	1
12	KRM „Pastrimi” sh.a	23	7	1	15	0
<b>Gjithsej rekomandimet</b>		<b>152</b>	<b>70</b>	<b>6</b>	<b>57</b>	<b>19</b>
<b>Totali i rekomandimeve për zbatim</b>		<b>133</b>	<b>53%</b>	<b>4%</b>	<b>43%</b>	

Nga tabela 5 vërehet se ZKA, në raportet e auditimit të vitit 2020, kishte dhënë 152 rekomandime dhe gjatë auditimit në vitin 2021 kishte vlerësuar zbatimin e rekomandimeve. Sipas këtij vlerësimi, 53% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 4% janë në proces të zbatimit, dhe 43% nuk janë zbatuar.

Nga tabela më lart shihet se 19 rekomandime janë të mbyllura. Ndërsa, 12 rekomandime të dhëna në 2020 që kanë të bëjnë me TI-në për Telekomin e Kosovës nuk janë testuar gjatë vitit 2021 për shkak se kompanisë ju është dhënë kohë më e gjatë për adresimin e tyre dhe testimi bëhet në vitet vijuese. Nga rekomandimet e mbetura për zbatim 70 prej tyre ishin të zbatuara, 6 pjesërisht dhe 57 prej tyre nuk janë zbatuar.

#### 4 Auditimet e performancës

ZKA gjatë vitit 2022 ka kryer 10 auditime të performancës, prokurimit dhe teknologjisë së informacionit. Këto auditime kanë mbuluar fusha me interes për qytetarët, Kuvendin e Kosovës dhe palët e tjera të interesit, me fokus në; arsim dhe kulturë, mjedis dhe siguri, zhvillim ekonomik dhe buxhet, prokurim publik si dhe teknologji të informacionit. Ndërlidhur me këtë është kryer një auditim përcjellës për vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve për Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës-SIMFK

**Tabela 6.** Numri dhe fushat e auditimeve të performancës, prokurimit dhe TI-së sipas fushave

Numri auditimeve	Fusha	Tema
1	Arsim dhe kulturë	Vlerësimi i nxënësve në testet kombëtare dhe ndërkombëtare
1	Zhvillim ekonomik dhe buxhet	Performanca financiare dhe operative NP Trepça Sh.A
1	Transmetuesi kombëtar	Menaxhimi i fondeve publike në Radio Televizionin e Kosovës
1	Mjedis dhe siguri	Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre mbi ndikimin në mjedis dhe ujëra
3	Prokurim publik	Prokurimi në Korporatën Energjetike të Kosovës (2018-2020)
		Projektet kapitale të Operatorit të Sistemit Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (2015-2021)
		Menaxhimi i projektit “Bashkimi i qytetit të Ferizajt”
2	Teknologji e informacionit	Sistemi Informativ i Gjendjes Civile në Agjencinë e Regjistrimit Civil
		Sistemi për Menaxhimin e Pagave-Payroll
1	Implementim i rekomandimeve	Auditim përcjellës për rekomandimet e dhëna për SIMFK-në në “Raportin Vjetor të Auditimit 2020” për pjesën e TI-së

Në këto auditime ZKA-ja ka përfshirë 30 organizata, prej tyre 10 Ministri, 11 Komuna, 4 Ndërmarrje Publike dhe 5 tjera (Rregullatorë, Agjenci, Transmetuesi Publik dhe Thesari i Kosovës). Për këto organizata janë dhënë 128 rekomandime, ndërsa me qëllim të adresimit të shpejt/urgjent të disa çështjeve ne kemi dhënë katër rekomandime për Qeverinë e Kosovës.

**Tabela 7.** Auditimet, entitetet, mesazhi auditimit dhe numri i rekomandimeve të dhëna

Auditimi/tema	Entitetet ne auditim	Mesazhi i auditimit	Numri i rekomandimeve
Menaxhimi i Fondeve Publike në Radio Televizionin e Kosovës	Transmetuesi publik	Radio Televizioni i Kosovës nuk ka menaxhuar si duhet me fondet publike të dedikuara për burimet njerëzore dhe programet vendore.	9
Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre mbi ndikimin në mjedis dhe ujëra	Ministri (dy) Rregullator-ZRRE dhe Komuna (katër)	Sistemi për licencimin e hidrocentraleve karakterizohet me mangësi të theksuara. Monitorimi i veprimtarisë së hidrocentraleve përshkohet me mangësi dhe për pasojë nuk kemi shfrytëzim efikas të ujërave duke rrezikuar kështu ujërat dhe mjedisin.	11
Performanca financiare dhe operative NP Trepça Sh.A	Ndërmarrje Publike	Trepça Sh.A nuk ka arritur të vendosë sisteme dhe kontrole adekuate të brendshme të cilat do ta mbështesnin arritjen e performancës financiare dhe operative pozitive, me theks në procesin e prodhimit.	16
Vlerësimi i Nxënësve në Testet Kombëtare dhe Ndërkombëtare	Ministri dhe Komuna (tri)	Auditimi ka konstatuar se ka mangësi në metodologjinë e vlerësimit të nxënësve dhe mos zbatim të kërkesave që dalin nga kurrikula.	9
Prokurimi në Korporatën Energjetike të Kosovës (2018-2020)	Ndërmarrje Publike	Korporata Energjetike e Kosovës nuk kishte arritur që t'i përdorë fondet publike në mënyrë ekonomike dhe efikase, kishte mungesë të transparencës si dhe kufizim të konkurrencës. E gjitha kjo ka bërë që disa nga objektivat e përcaktuara përmes prokurimit publik të mos arrihen.	8

Projektet kapitale të Operatorit të Sistemit Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (2015-2021)	Ndërmarrje Publike Rregullator-ZRRE Ministri/ Inspektorati	Edhe pse KOSTT kishte proces të duhur të vendosjes së prioriteteve për investime, zbatimi i tyre nuk është bërë në mënyrë efektive. Aktivitetet e prokurimit për këto investime nuk kishin qenë mjaftueshëm efektive dhe efikase, e në disa raste as ekonomike. Megjithatë, projektet e realizuara kishin mundësuar operim stabil të sistemit të transmisionit të energjisë	15
Menaxhimi i projektit “Bashkimi i qytetit të Ferizajt”	Komunë Ministri	Komuna e Ferizajt nuk ishte efikase në planifikimin dhe menaxhimin e projektit “Bashkimi i qytetit” sepse kishte marrë më shumë kohë dhe kishte kushtuar më shumë se që ishte paraparë. Po ashtu Komuna nuk ka bërë matjen/dokumentimin e arritjes së objektivave të ndërtimit të projektit dhe nuk ka informacion si ka ndikuar investimi në përmirësimin e jetës së qytetarëve	13
Sistemi Informativ i Gjendjes Civile në Agjencinë e Regjistrimit Civil	Ministri Agjenci-ARC dhe Komuna (dy)	Sistemi Informativ i Gjendjes Civile ka mangësi në qeverisje, operacione dhe në kontrolle të aplikacionit. Në këtë sistem nuk garantohet mjaftueshëm integriteti i të dhënave në çdo kohë si dhe kontrollet e aplikacionit që zbatohen në SGJC nuk sigurojnë që vetëm të dhëna të sakta dhe të vlefshme vendosen dhe azhurnohen në sistem.	27
Sistemi për Menaxhimin e Pagave-Payroll	Ministri dhe Thesari i Kosovës	Sistemi që përdoret për menaxhimin e pagave nuk i përmban standardet e kërkuara që të menaxhojnë në mënyrë efikase shpërndarjen e tyre. Procesi i ekzekutimit të pagave si dhe sistemi që menaxhon këtë proces kanë nevojë për përmirësim, me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe saktësisë së të dhënave.	19

<p>Auditim përcjellës për rekomandimet e dhëna për SIMFK-në në “Raportin Vjetor të Auditimit 2020” pë pjesën e TI-së</p>	<p>Ministri (dy) Thesari Kosovës Komonë</p>	<p>Thesari dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kanë bërë progres të rëndësishëm, por jo të mjaftueshëm për zbatimin e plotë të rekomandimeve. Si rrjedhojë ende vazhdojnë mangësitë në sigurimin e mekanizmave për sigurinë e informacionit dhe kontrollet e aplikacionit që zbatohen në SIMFK për të garantuar saktësinë, vlefshmërinë, si dhe ruajtjen, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave në sistemin e informacionit.</p>	<p>1</p>
--	---	--	----------

Krahas auditimeve, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, thellimit të bashkëpunimit dhe ngritjes profesionale, gjatë vitit 2022 ZKA ka zhvilluar një sërë aktivitete në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Aktivitete kryesore të zhvilluara në funksion të mandatit të ZKA-së janë:

### **Zyra Kombëtare e Auditimit bëhet pjesë e Grupit Punues për TI në EUROSAI**

Në nëntor të vitit 2022, ZKA është pranuar si anëtare e plotë në Grupin Punues për Teknologjinë e Informacionit në EUROSAI.

Grupi Punues i TI-së (ITWG) në EUROSAI ka për qëllim të inkurajojë Institucionet Supreme të Auditimit Evropiane në punën e tyre rreth auditimeve të TI-së si dhe në përdorimin e TI-së në punën e përditshme përmes shkëmbimit të praktikave më të mira dhe aktiviteteve të përbashkëta.

ITWG EUROSAI ka për qëllim të zhvillojë më tej shkëmbimin institucional të ekspertizës dhe përvajave ndërmjet ISA-ve të rajonit Evropian dhe të inkurajojë zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e TI-së. Duke qenë pjesë e ITWG-së, auditorët e TI-së së ZKA-së janë më afër zhvillimeve në fushën e auditimeve të TI-së dhe do kenë mundësi më të madhe që të bashkëpunojnë me ISA-t Evropiane.

### **Konferenca YOUNG EUROSAI**

Në konferencën e pestë “Young EUROSAI” të mbajtur në Stokholm të Suedisë në shtator 2022, kanë marrë pjesë për herë të parë dy përfaqësues nga ZKA-ja. Kjo konferencë është organizuar nga SNAO me temën “Një kulturë eksperimentale”. Përfaqësuesit nga ZKA-ja kanë marrë pjesë në panel ku edhe kanë prezantuar kulturën organizative në ZKA ndër vite. Konferenca “Young EUROSAI” mbahet çdo dy vite dhe është një mundësi e mirë për auditorët e rinj që të ndajnë ide të reja dhe të eksplorojnë zgjidhje për sfidat me të cilat përballen ISA-t sot dhe në të ardhmen.

## Bashkëpunimi me UN Women



UN Women po zbatojnë një sërë aktivitete për të mbështetur ISA-t në Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut që të integrojnë perspektivën gjinore në auditim. Njëra nga to është seminari dy ditor në Prishtinë i organizuar nga UN Women për përfaqësuesit e ISA-ve rajonale dhe Institucionit

të Avokatit të Popullit. Auditorja e Përgjithshme ka vlerësuar mbajtjen e këtij seminari si një iniciativë e mirë për të shtyrë përpara procesin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Ndërlidhur me këtë fushë, ZKA-ja ka në proces auditimin e performancës “Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”. Në kuadër të këtij auditimi, UN Women ka organizuar vizitë studimore në Stokholm të Suedisë dhe trajnim tre ditor në Shqipëri për buxhetimin përgjegjës gjinor/analiza e ndikimit të politikës gjinore

### Rishikimi kolegjial - Bashkëpunimi i ISA-ve në nivel shtetesh për auditimet e agjendës së Qëllimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm

Një dokument ku janë dhënë rekomandime për auditorët se si duhet të ndërtohet gasja për auditimet e agjendës së Qëllimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals) është punuar nga Gjykata Turke e Llogarive, Zyra e Koordinatorit Rezident të Kombeve të Bashkuara në Turqi dhe Zyra vendore e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Turqi, brenda kontekstit të Grupit për Projekt të EUROSAT-it.

Zyra Kombëtare e Auditimit si anëtare e EUROSAT-it, është caktuar si një nga ISA-t që do të bëjë rishikimin kolegjial të këtij dokumenti. ZKA ka bërë rishikimin e dokumentit, ka dërguar komentet e saj për plotësim/ndryshime dhe pas shqyrtimit të këtyre komenteve nga Grupi punues, ka pranuar versionin e ri të plotësuar.

Këtu vlen të përmendet, se komentet e dhëna nga ZKA janë trajtuar dhe reflektuar në këtë dokument, i cili pritet të shërbejë si bazë për kryerjen e auditimeve që lidhen me Agjendën për Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030.

### Auditimi paralel në fushën e teknologjisë së informacionit ndërmjet ZKA dhe KLSH

Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit të Shqipërisë gjatë vitit 2022 kanë filluar një projekt të përbashkët në fushën e auditimeve të teknologjisë së informacionit. Auditimi paralel në fushën e TI-së është i pari i këtij lloji për ZKA-në i cili është duke u zhvilluar për Ujësullësit në Tiranë (nga KLSH) dhe Prishtinë (nga ZKA). Procesi po zhvillohet në bazë të kërkesave për auditimet e përbashkëta, udhëzuesve për auditimet e TI-së si dhe praktikave përkatëse.

Lidhur më këtë projekt, ekipet e auditimit kanë zhvilluar takime të përbashkëta më

qëllim të dakordimit të aktiviteteve dhe shkëmbimit të përvojave. Procesi i auditimit është në vazhdim dhe finalizimi i raporteve individuale pritet të përfundoj në maj 2023 për të nxjerrë rezultate të përbashkëta nga dy auditimet.

## **Bashkëpunimi i ZKA-së dhe Shoqërisë civile**

*Grupi punues nga EUROSAI për angazhimin e shoqërisë civile në auditim për Auditimet e Performancës*

Përfaqësues nga ZKA kanë marrë pjesë në grupe punuese për të përcaktuar se si të angazhohen shoqëria civile nga ISA dhe EUROSAI. Qëllimi i këtij grupi është zhvillimi i informacioneve për ISA-t, EUROSAI-n dhe auditorët e tyre në zbatimin e praktikave përkatëse të angazhimit të shoqërisë civile në fazat e ndryshme të punës së auditimit. Ky projekt është lansuar në prill 2022 dhe dhjetë (10) ISA i janë përgjigjur ftesës për t'ju bashkëngjitur grupit punues, ndër ta edhe ZKA. Në këtë aktivitet janë shkëmbyer përvojat e fundit profesionale të ISA-ve në bashkëpunim me shoqërinë civile.

*Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile, profesionale dhe donatorët për Auditimet e Performancës*

ZKA-ja në aspektin strategjik synon rritjen e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, profesionale dhe donatorët gjatë gjithë procesit të auditimit.

Lidhur me këtë, gjatë vitit 2022 ZKA ka organizuar tryeza të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit dhe partneritetit me organizata, shoqatat profesionale dhe donatorët, për fushën e auditimeve të performancës.

Qëllimi i këtyre takimeve është “Fuqizimi i bashkëpunimit mes ZKA-së dhe shoqërisë civile për të rritur ndikimin e auditimit në institucionet publike”.

Në takimet e zhvilluara, janë trajtuar tema të mundshme për auditim që janë me interes të veçantë për t'u audituar nga ZKA në sezonin auditues 2022–2023. Ata kishin rastin për të propozuar tema të rëndësishme për t'u konsideruar nga Auditorja e Përgjithshme për planin e auditimit. Gjithashtu, ZKA në këto takime ka bërë prezantimin e Planit të Auditimit 2022-2023 si dhe diskutimin për mundësitë e rritjes së bashkëpunimit përgjatë procesit të auditimeve të performancës. Si rezultat i këtij bashkëpunimi në Planin Vjetor të Auditimit për sezonin 2022-2023 janë përfshirë dy tema të auditimit që janë propozuar nga Organizatat e Shoqërisë Civile (Sponsorizimi i sportit dhe kontratat e institucioneve publike me Caritas Kosova).

## **5 Kontrolli i cilësisë**

Menaxhimin e cilësisë në procesin e auditimit realizohet në përputhje të plotë me vizionin, misionin dhe mandatin e ZKA-së, si institucion i besueshëm dhe përmes kryerjes së auditime cilësore.



Qëllimi i auditimit është që t'i ofrojë siguri palëve të interesit dhe publiku të gjerë për cilësinë e raporteve financiare dhe menaxhimit financiar, kjo arrihet përmes kontrollit, monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.

Rëndësia e kryerjes së auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ka të bëjë që:

- sigurojë cilësi në auditimet e kryera;
- forcojë besueshmërinë e palëve të interesit në raportet e auditimit;
- rrisë transparencën e procesit të auditimit;

Sistemi ynë i menaxhimit të cilësisë bazohet në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare për Menaxhimin e Cilësisë, ISSAI 140. Ne jemi të përkushtuar të ofrojmë punë audituese me cilësi të lartë përmes Udhëzuesve të auditimit, rregulloreve dhe akteve të tjera me të cilët operon ZKA. Këto udhëzime rregullojnë metodologjinë e kryerjes së auditimeve dhe ofrojnë informata dhe udhëzime të mjaftueshme për t'i ndihmuar auditorët gjatë procesit të auditimit të punojnë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), parimet e INTOSAI, dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) si dhe udhëzimet të përshkuara në Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI (KDPI).

Në të gjitha auditimet që kryhen, menaxhimin e cilësisë ZKA e siguron përmes 3 (tri) komponentëve; kontrolli i cilësisë, monitorimi i cilësisë dhe sigurimi i cilësisë kryhet në disa nivele, duke u nisur nga udhëheqësit e auditimit dhe ndihmësit e Auditorit të Përgjithshëm. Përveç kësaj ZKA-ja ka të themeluar edhe Departamentin për Metodologji dhe Departamentin për Sigurimin e Cilësisë në Auditim, me qëllim të ngritjes së cilësisë së auditimeve në një nivel sa më të lartë. Ky departament, i cili vepron në pajtim me SNISA-t 140 (Kontrolli i cilësisë), kryen rishikimin e auditimeve të realizuara.

Përzgjedhja e auditimeve për rishikim nga ky departament, gjatë vitit 2022 ka pasur parasysh madhësinë, kompleksitetin e auditimeve dhe mbulueshmërinë e të gjitha ekipeve të auditimit në procesin e rishikimit të dosjeve të auditimit.

Për sezonin auditues 2021/2022 janë kryer 48 rishikime të auditimeve të rregullsisë, prej tyre për fazën e planifikimit ishin kryer 30 rishikime të cilësisë, ndërsa 18 rishikime për fazën e ekzekutimit dhe raportimit.

Për sezonin 2022/2023 janë kryer/proces 36 rishikime të auditimeve të rregullsisë, prej tyre për fazën e planifikimit janë kryer 10 rishikime të cilësisë, ndërsa 26 rishikime janë planifikuar për fazën e ekzekutimit dhe raportimit.

Për auditimet e performancës, monitorimi dhe kontrolli i cilësisë është një proces që zbatohet në çdo auditim. Fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të auditimit

janë subjekt i rishikimit në të gjitha nivelet menaxheriale. Rishikimi kolegjial për memorandumit e parastudimit dhe draft-raportin e auditimit bëhet nga anëtarët e emëruar (auditorë me përvojë) brenda divizionit. Për disa nga temat janë angazhuar këshilltarë të jashtëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë (SNAO).


**Bashkëpunimi më organet e sundimit të ligjit** - Me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit dhe për të rritur përgjegjshmërinë në sektorin publik, në pajtim me standardet e auditimit dhe me legjislacionin e fushës penale, gjatë këtij viti kemi dërguar 77 raste me elemente potenciale të veprave penale, mashtrimit dhe korrupsionit në Prokurori të Shtetit. Rastet janë identifikuar gjatë ushtrimit të aktiviteteve audituese dhe rrjedhin kryesisht nga fusha e prokurimit, pa i përjashtuar edhe fushat tjera.


Në raport me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit kemi avancuar mënyrat e komunikimit, si dhe të shkëmbimit të informacioneve me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit

# 3

## Kapitulli

Menaxhimi Financiar dhe Administrativ





## Kapitulli III - Menaxhimi Financiar dhe Administrativ

### 1 Menaxhimi financiar

ZKA-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe si i tillë menaxhohet dhe shpenzohet me një përgjegjësi dhe llogaridhënie të lartë. Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022, mjetet e ndara për ZKA-në ishin në shumë prej 3,066,355€. Buxheti ishte i ndarë në katër kategori ekonomike: Paga dhe mëditje, Mallra dhe shërbime, Shërbime komunale dhe Investime kapitale.

Gjatë këtij vitit ka pasur ndryshime në kategorinë e shpenzimeve kapitale, si rrjedhojë e vendimit të Qeverisë të datës 07.11.2022 ku mjetet e dedikuara për blerjen softueri “Menaxhimi i burimeve njerëzore” për nevojat e ZKA-së në shumë prej 20,000€ janë liruar nga alokimi dhe janë kthyer në buxhetin e Kosovës.

Buxheti ishte i ndarë në katër kategori ekonomike, si në vijim:

- Paga dhe shtesa në vlerë prej 2,291,035€;
- Mallrave dhe Shërbimeve ishte në vlerë prej 685,320€;
- Shërbimeve komunale ishte në vlerë prej 40,000€; dhe
- Investimeve kapitale ishte në vlerën prej 30,000€.


Buxheti final në fund të vitit ishte 3,046,355€. Gjatë viti 2022 buxheti është shpenzuar në vlerë prej 2,785,368€, apo 91%.

**Tabela 8. Shpenzimi i buxhetit përgjatë tri viteve 2022-2020 (në EUR `000)**


Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	%
<b>2022</b>				
<b>Buxheti i përgjithshëm</b>	<b>3,066</b>	<b>3,046</b>	<b>2,785</b>	<b>91%</b>
Pagat dhe mëditjet	2,291	2,291	2,154	94 %
Mallrat dhe shërbimet	685	685	572	84%
Shërbimet komunale	40	40	35	88%
Investimet kapitale	50	30	24	80%
<b>2021</b>				
<b>Buxheti i përgjithshëm</b>	<b>2,796</b>	<b>2,791</b>	<b>2,750</b>	<b>99%</b>
Pagat dhe mëditjet	2,088	2,192	2,192	100%

Mallrat dhe shërbimet	605	510	475	93%
Shërbimet komunale	50	36	34	92%
Investimet kapitale	53	53	49	93%
<b>2020</b>				
<b>Buxheti i përgjithshëm</b>	<b>3,115</b>	<b>3,084</b>	<b>3,041</b>	<b>99%</b>
Pagat dhe mëditjet	2,078	2,216	2,216	100%
Mallrat dhe shërbimet	692	564	523	93%
Shërbimet komunale	45	32	30	96%
Investimet kapitale	300	272	272	100%

**Grafiku 2.** Shpenzimet nëpër kategori ekonomike nëpër vite 2020-2022



**Grafiku 3.** Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë vitit 2022



Grafikun 3 pasqyron shpenzimin e buxhetit të ZKA-së nëpër kategoritë ekonomike gjatë vitit 2022. Nga kjo vërehet se buxheti i ZKA-së shpenzohet në kategorinë e pagave dhe shtesave prej 77.3 %, derisa në kategorinë e Mallrave dhe shërbimet në vlerë prej 20.5% të buxhetit. Kategoritë tjera si, shpenzimeve komunal (1.3 %) dhe tek investimeve kapitale(0.9 %).

- Në **Paga dhe shitesa** është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 2,291,035€, derisa numri i miratuar i personelit ishte 180 pozita. Shpenzimet në këtë kategorinë gjatë vitit 2022 janë më të ulëta se sa buxheti i aprovuar, për arsye se gjatë 2022 nga ZKA janë larguar tetë (8) të punësuar, si; dy (2) nga pozitat e larta menaxhuese, katër (4) nga stafi auditorë dhe dy (2) nga stafi mbështetës.

Po ashtu, gjatë këtij viti, nëntë (9) punonjësit janë në pushim të lehonisë, si dhe katër (4) të punësuar kanë qenë në pushim pa pagesë. Buxheti i shpenzuar në paga dhe shitesa është 2,154,086€ apo 94%.

Gjatë 2022 janë rekrutuar 11 të punësuar të rinj; një (1) pozitë e lartë menaxhuese, gjashtë (6) auditorë, si dhe katër (4) staf mbështetës.


- Në **Mallra dhe shërbime** është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 685,320€. Buxheti i shpenzuar në këtë kategori është 572,249€ ose 84%. Zërat më të mëdha në këtë kategori janë:
  - ✓ Qiraja për objektin, e ZKA-së që pjesëmarrja e sajë në vlerën totale të shpenzimeve të buxhetit përfshijnë 162,000€ apo 29% në këtë kategori;
  - ✓ Mirëmbajtjet, në vlerë prej 29% ose 163,695€ e kësaj kategorie përbëjnë shpenzimet e mirëmbajtjes, në të cilën përfshihen sigurimi i objektit, mirëmbajtja e ndërtesave, mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare.
  - ✓ Pajisjet dhe furnizimet për zyrë, përbejnë 5% apo 31,332€ të mallrave dhe shërbimeve. Këtu janë përfshirë kryesisht pagesat për blerje të pajisjeve të TI-së dhe furnizime të tjera për zyre për nevoja të ZKA-së për vitin 2022.
  - ✓ Shpenzimet intelektuale këshillëdhënëse, ku përfshihen shpenzimet për auditimin e komunave dhe institucioneve të pavarura që përbejnë 9% ose 50,244€ të shpenzimeve nga kjo kategori. Në këtë shumë prezantohen pagesa prej 42,534 € ose 80% e vlerës së kontratës (53,168€) të lidhur me Operatorin Ekonomik për auditimin e PVF – 2021, janë 25 organizata buxhetore. Ndërsa, shuma prej 7,710€ ose 20% ka të bëjë me kontratën prej (38,500€), të lidhur me Operatorin tjetër Ekonomik i angazhuar për auditimin e PVF – të vitit 2022 të shtatëmbëdhjetë (17) organizatave buxhetore.
  - ✓ Shpenzimet tjera, në vlerë prej 66,950€ apo 12 % e totalit janë shpenzime që kanë të bëjnë me shpenzimet e edukimit profesional, kontraktuale, ushqim dhe pije dhe shpenzime të ndryshme që lidhen me funksionimin e zyrës.
  - ✓ Shpenzimet për naftë për nxehe qendrore për objektin e ZKA-së bashkë me

shpenzimet e naftës për veturat zyrtare përbëjnë 6% të shpenzimeve nga kjo kategori ose në vlerë prej 32,930€.

- ✓ Shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit, janë në vlerë prej 60,000€ apo 10%. Prej tyre 26,550€ janë kryesisht shpenzime brenda vendit që janë në funksion të kryerjes së veprimtarisë audituese.
- Në **Shërbimet komunale** është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 40,000€. Buxheti është shpenzuar në vlerën prej 35,104€ apo 88%, përqindja me e larta në këtë kategori janë shpenzimet e rrymës që përfshijnë 77% e të gjitha shpenzimeve.
- Në **kategori të Investimeve kapitale** është miratuar buxheti në shumë prej 50,000€ për tri (3) projekte kapitale. Mirëpo me kërkesë nga ZKA në MFPT, mjetet financiare të aprovuara me Ligjin Nr. 08/I-066 për projektin kapital “Softueri për Menaxhimin e burimeve njerëzore” në shumën prej 20,000 € janë liruar nga alokimi dhe janë kthyer në buxhetin e shtetit. Si rrjedhojë në këtë kategori buxheti final ishte në shumë prej 30,000€.

Buxheti i shpenzuar është në vlerë prej 23,884€, apo 80% e buxhetit në këtë kategori. Shpenzimet kanë të bëjnë me furnizimin me një server si pjesë e programit për rifreskimin e infrastrukturës së TI-së në objektin e ZKA-së në vlerë prej 13,901€, si dhe për furnizimin me një server si pjesë e programit për përfortimin e sigurisë së infrastrukturës ( rrjetit ) në objektin e ZKA-së, në vlerë prej 9,982€.

**Grafiku 4. Shpenzimet kryesore në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2022**





## 2 Burimet Njerëzore

Mbështetur në Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, ZKA ka të aprovuar kornizën e brendshme rregullative përmes së cilës rregullon menaxhimin dhe funksionimin e Burimeve Njerëzore. Divizioni i burimeve njerëzore ofron përkrahje profesionale për të gjithë punonjësit e ZKA-së, rrjedhimisht ushtrimi i veprimtarisë është në përputhje të plotë me rregullativën ligjore në fuqi dhe me udhëzuesit dhe politika e INTOSAI dhe EUROSAI.

ZKA, procesin e rekrutimit dhe statusin e të punësuarit e ka të rregulluar në përputhje me parimet e përcaktuara me Ligjin përkatës dhe duke i marrë parasysh vlerat dhe parimet e legjislacionit në fuqi që rregullojnë marrëdhënien e punës.

Struktura e personelit ndahet në pesë (5) kategori, si; Kategori e lartë drejtuese; kategori e mesme drejtuese; kategori ulët drejtuese; kategori profesionale, si dhe kategori mbështetëse.

Struktura e numrit të përgjithshëm të personelit përbehet prej 83% personel auditues (përfshirë pozitat drejtuese), dhe 17% janë punonjës të shërbimeve profesionale mbështetëse.

Në vitin 2022, ZKA-ja ka rekrutuar dhjetë (10) punonjës të rinj në nivelin profesional, si dhe një (1) punonjës të nivelit të lartë drejtues me mandat 5 vjeçar. Derisa, marrëdhënien e punës e kanë shkëputur tetë (8) punonjës, ku përfshihen shtatë (7) dorëheqje dhe një (1) përfundim i mandatit. ZKA në fund të vitit 2022 kishte 166 punonjës.

Tabela 9 paraqet të dhënat rreth nëpunësve, ku përfshihet numri i përgjithshëm i nëpunësve, përqindja sipas gjinisë, moshë mesatare, numri i nëpunësve nga komunitetet si dhe përqindja e lëvizjeve/largimeve.

**Tabela 9. Personeli i ZKA-së, përgjatë tri viteve të fundit**

Viti	Numri i personelit në fund të vitit	Personeli Gjinia Femërore (%)	Personeli Gjinia mashkullore (%)	Moshë Mesatare (vite)	Numri i personelit nga komunitetet	Lëvizja e personelit %
2022	166	55.42 %	44.58%	43.10	4	4.22
2021	164	52.4%	57.6%	42.7	4	4.27
2020	171	53.2%	46.8%	42.2	4	1.75

Të dhënat pasqyrojnë që lëvizjet e personelit në 3 vitet e fundit ishin të baraspeshuara (1-4%) karshi numrit të përgjithshëm të stafit që paraqet një element të rëndësishëm në ruajtjen e stafit profesional në proceset audituese. Për sa i përket strukturës gjinore, mbi 55.42% e nëpunësve i përkasin gjinisë femërore, ku përfaqësohen edhe në pozita të larta drejtuese.

Mosha mesatare e nëpunësve ka një rritje të lehtë nga viti i kaluar, 82.53% e nëpunësve të ZKA-së janë të moshës së mesme prej 25 deri në 50 vjet, kurse të moshës prej 51 deri në 65 vjet janë 17.47% apo me moshë mesatare të personelit prej 43 vjet.

Sa i përket përfshirjes së komuniteteve në ZKA, edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për të tërhequr më shumë kandidatë nga komunitetet, interesimi nga kjo kategori mbetet ende i vogël. Aktualisht, ZKA ka të punësuar 4 persona apo 2.4% e numrit të përgjithshëm.

Struktura e udhëheqëse e ZKA-së, përfshin nivelin e lartë drejtues: (Zëvendës Auditori; Ndihmës Auditor të Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm Administrativ). Nivelin e mesëm (Drejtor Departamenti; Drejtorët e Shërbimeve Përkrahëse e Administrative) dhe nivelin e ultë drejtues (Udhëheqës Divizioni).

Në pozitat audituese, përfshihen (Auditorët specialist, Auditor senior, Auditor, dhe Auditor junior). Këto kategori përbejnë pjesën më të madhe të nëpunësve të ZKA-së, ku vëmendje të veçantë i kushtohet aftësimin të tyre profesional. Përgjatë viteve është investuar përmes formave të ndryshme të përkrahjes profesionale, si përmes ndjekjes së programeve të certifikimit, ashtu edhe në mbajtjen e njohurive përmes edukimit të vazhdueshëm profesional.

### 3 Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit

Zhvillimi profesional është objektiv kryesor dhe i vazhdueshëm i ZKA-së duke përkrahur dhe investuar tek personeli auditues dhe jo auditues, që në mënyrë direkte rezultojnë në arritjen e objektivave strategjike në mënyrë profesionale në proceset audituese. Kjo qasje ka për qëllim që personeli ynë të ketë shkathtësitë dhe kapacitetet e duhura për të përmbushur detyrat e përcaktuara në realizimin e objektivave audituese dhe mandatin ligjor.

**Tabela 10. Auditorët e certifikuar nëpër nivele në skemat e certifikimit**

Nivelet e certifikimit	Auditor i certifikuar i sektorit publik	Auditor i sektorit publik	Asistent i Auditorit i certifikuar i sektorit publik	Auditorët e certifikuar të TI-së.	Auditor i certifikuar i performancës
Numri i auditorëve	87	12	4	3	18

ZKA, ka investuar në certifikimin e stafit auditues dhe edukimit të vazhdueshëm profesional në hap me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Në skemën e certifikimit publik nëpër nivele janë certifikuar 107 auditorë, prej tyre 87 auditorë të certifikuar në sektorin publik, 12 auditorë të sektorit publik dhe 4 asistentë i auditorit në sektorin publik.

Për auditimet e performancës janë certifikuar 18 auditorë në kuadër të një programi për Zhvillimin e Kapaciteteve Institucionale ndërmjet SNAO dhe ZKA. Po ashtu, ZKA në fushën e Auditimeve të Teknologjisë së Informacionit ka 3 auditor të certifikuar dhe një (1) auditor është në proces të certifikimit.

Stafi i ZKA-së, njohuritë profesionale ekzistuese i plotësojnë përmes ndjekjes së trajnimeve, ku fillimisht kryhet identifikimi i nevojave për trajnim të stafit që kryesisht bëhet gjatë vlerësimit vjetor të performancës. Në bashkëpunim me departamentet përkatëse, Divizioni për Burime Njerëzore koordinon aktivitetet për hartimin dhe zbatimin e Planeve të Trajnimit çdo vit.

Plani i trajnimeve për vitin 2022 përbëhet nga trajnimet e brendshme dhe jashtme. Trajnimet e brendshme zhvillohen në dy periudha të ndarë në dy sesione (Sesioni Janar – Shkurt dhe Sesioni i Shtatorit).

Plani i trajnimeve është zhvilluar me një sistem të kombinuar përmes platformave online, qasjes fizike, seminareve virtuale dhe pjesëmarrjes nëpër konferenca e ngjarje të ndryshme. Kjo përfshin edhe pjesëmarrjen në trajnime në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP), të cilën ZKA e ka të rregulluar përmes dy shoqatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

Gjatë vitit 2022, janë zhvilluar 61 aktivitete të ndryshme (trajnime, punëtori, vizita studimore), mirëpo ato që veçohen janë:

- Procesi i auditimit përmes SITA, me theks arkivimi i dokumenteve dhe dëshmimeve të auditimit;
- Përdorimi i procedurave analitike substanciale;
- Menaxhimi i rrezikut;
- Proceset e rekrutimit të pavarur, profesional dhe sipas meritës;
- Vlerësimi i rezultateve në punë;
- Zhvillimi i karrierës për gratë që punojnë në sektorin publik në Kosovë;
- Përdorimi i gjuhës së thjeshtë në shkrimin e raporteve të Auditimit;
- Auditimi i barazisë gjinore në Ballkanin Perëndimor;
- Zhvillimi i Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë;
- Roli i zbatimit të rekomandimeve në përmirësimin e qeverisjes dhe kontrollit për menaxhimin e parasë publike, ngritjen e performancës në komuna dhe përfitimit të garantëve.

Përveç programeve të trajnimit, stafi i ZKA-së në vazhdimësi realizon takime e sesione mbështetëse ku përfiton njohuri nga praktika e ekspertëve me të cilët ZKA ka Marrëveshje Bashkëpunimi, si: Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, Banka Botërore, IDI, Bashkimi Evropian, Ambasada e Mbretërisë Holandeze, OSBE, MFPT, Projekti i Ambasadës të Britanisë së Madhe në Republikën e Kosovës, i zbatuar nga BDO, etj.

### Fotogaleria 1. Trajnimet për stafin e ZKA-së.



## 4 Shërbimet e përbashkëta

Departamenti për shërbime të përbashkëta, përmes divizioneve përkatëse, ofrojnë shërbime përkatëse për personelin e ZKA-së. Në kuadër të këtij departamenti janë: divizioni për logjistikë, divizioni për administrim të dokumenteve zyrtare dhe divizioni për përkthime.

**Divizioni për logjistikë** ofron mbështetje të vazhdueshme për ekipet audituese, duke ofruar shërbime të transportit si dhe të përkrahjes përmes furnizimeve të materialeve të nevojshme për punë në zyrë. ZKA, disponon me njëmbëdhjetë (11) vetura zyrtare, shtatë (7) nga të cilat janë plotësisht të amortizuara.

Pasuritë e blera gjatë vitit 2022 me vlerë prej 21,866€ (nën 1,000€), janë të regjistruara në softuerin elektronike E-Pasuria, ndërsa pasuritë e blera me vlerë mbi 23,889€ (mbi 1,000€) pasuri kapitale, janë të regjistruara në SIMFK.

Duhet theksohet se ZKA ka pranuar pasuri nga Agjencioni i Aviacionit Civil (ARC), e cila e njëjta është bartur në regjistrat kontabël të pasurive.

Në fund të vitit, me vendim të Auditorës së Përgjithshme është themeluar komisioni për inventarizim të pasurive të ZKA-së, i cili ka përgatitur dhe dorëzuar raportin e inventarizimit, ku janë evidentuar konkluzione dhe rekomandime rreth pasurive të ZKA-së.

**Divizioni për administrimin e dokumenteve zyrtare** në bashkëveprim me departamentin e TI-së ka vazhduar me menaxhimin/arkivimin elektronik të dokumenteve zyrtare. Përmes platformës elektronike, auditorët kanë qasje në dokumentet e arkivuara, të cilat janë të nevojshme për punët vijuese në auditim. Në vitin 2022, ky divizion ka protokolluar 2,600 dokumente të ndryshme.

**Divizioni për përkthime** ofron shërbimin e përkthimit të dokumenteve zyrtare në gjuhën angleze dhe serbe, dhe anasjelltas, si dhe përkthimin e drejtpërdrejt në takimet dhe punëtoritë e organizuara nga ZKA.

Si rrjedhojë e numrit të kufizuar në kuadër të këtij divizioni, si dhe volumit të madh të nevojave për përkthim të dokumenteve, gjatë vitit 2022 është angazhuar një operator i jashtëm për ofrimin e përkrahjes në përkthimin e raporteve të auditimit.

## 5 Teknologjia informative

Departamenti për Teknologji të Informacionit në ZKA është përgjegjës për menaxhimin e tërë infrastrukturës së TI-së, rrjedhimisht mbi këtë bazë në vazhdimësi ka përkrahur personelin e ZKA-së që të arrijë të përmbush objektivat e përcaktuara vjetore.

Gjatë vitit 2022, ky departamenti është përballur me shumë sfida që në të njëjtën kohë ishin edhe mundësi për t'u përmirësuar. Me rritjen e punës në distancë, departamentit i TI-së në ZKA, ka siguruar rrjetin dhe pajisjet dhe të gjitha të dhënat kundër një sërë kërcënimesh kibernetike, duke përfshirë phishing , malware, ransomware, si dhe kërcënimet e brendshme.

Sfidë për ZKA në këtë fushë për vitin 2022 ishin:

- buxheti, çmimet e produkteve dhe shërbimeve në TI kanë pësuar rritje;
- vonesat në transportin e produkteve që kanë shkaktuar vonesa në liferim të pajisjeve të TI-s;
- menaxhimi i sigurisë kibernetike për shkak të sulmeve të shpeshta dhe probleme me të cilat jemi ballafaquar;
- Largimi i një punëtori të TI-së me përvojë dhe vështirësitë për rekrutimin e stafit të ri.

Mbi këtë bazë, ne kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të rifreskuar infrastrukturën e sigurisë dhe të azhurnojmë konfigurimet e nevojshme, si duke i hartuar politika për sigurinë e TI-së.

Sfidë për ZKA në këtë fushë mbetet:

- siguria kibernetike do të vazhdojë të jetë një shqetësim kryesor për departamentin e TI-së;
- kufizimi në përcjelljen e trendëve të cilat po ndryshojnë shumë shpejtë në fushën e teknologjisë, si dhe mundësit e trajnimit për përcjelljen e zhvillimeve të reja në këtë fushë.

## 6 Prokurimi

ZKA në përputhje me Planin Vjetor të Prokurimit për vitin 2022, ka zhvilluar gjithsej 33 aktivitete prokurimi të cilat kryesisht kanë qenë për furnizime dhe kryerje të shërbimeve.


Njësia e prokurimit në përputhje me informimin/njoftimin zyrtar nga KRPP nga data 01/02/2021, ndërlidhur me plotësim/ndryshimin A01 - Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik (RRUOP) nr.001-2022 për prokurimi publik, ka filluar në përdorim të dy moduleve të reja të sistemit të prokurimit elektronik“ Modulin për menaxhim të kontratës” dhe “Modulin për vlerësim të performancës së kontraktuesve”.


Bazuar në informimin zyrtar të KRPP, prej 01/08/2021 njësia e prokurimit aplikon procedurat me vlera minimale përmes platformës elektronike E-prokurimi.

# 4

## Kapitulli

Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e jashtme







## Kapitulli IV - Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e jashtme

### 1 Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit

Gjatë këtij viti (2022), ZKA ka zhvilluar komunikim të vazhdueshëm dhe të frytshëm me palët e interesit si dhe ka avancuar qasjen gjithëpërfshirëse, duke qenë pjesëmarrëse në shumë takime, punëtori e konferenca brenda dhe jashtë vendit.

Në aspektin kombëtar është forcuar më tej partneriteti me komisionet parlamentare dhe organizatat e shoqërisë civile, kurse në aspektin ndërkombëtar është avancuar bashkëpunimi me Institucionet Supreme të Auditimit përmes takimeve, punëtorive e aktiviteteve të tjera në kuadër të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t, si dhe në nivel regional në kuadër të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidatë dhe kandidatë të mundshme për anëtarësim në BE.

**Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës**, është intensifikuar kryesisht përmes punës me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere (KBPT).

Auditorja e Përgjithshme ka prezantuar në seancë plenare gjetjet dhe rekomandimet e Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2021. Gjithashtu, në Kuvend është shqyrtuar edhe Raporti Vjetor i Performancës i ZKA-së për vitin 2021.

Po ashtu, duhet të theksohet se në vazhdimësi ZKA-ja ka përgatitur për KMFP-në dhe KBPT-në informatat e nevojshme dhe përmbledhjet për raportet e auditimeve të kryera, si dhe ka ofruar deputetëve informatat dhe këshillat e nevojshme në lidhje me raportet e auditimit që diskutohen në komisionet parlamentare.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) gjatë vitit 2022 ka shqyrtuar 25 raporte të auditimit, prej tyre 14 të rregullsisë, 8 të performancës, si dhe Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2021, Raportin Vjetor të Performancës së ZKA-së për vitin 2021, dhe Planin Vjetor të Auditimit 2022/23.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe intensifikimit të aktiviteteve me Kuvendin, ZKA-ja në prill/ maj ka mbajtur dy punëtori me temë "Rritja e ndikimit të auditimit përmes zbatimit të rekomandimeve". Në kuadër të këtyre dy punëtorive përfaqësuesit e ZKA-së, anëtarët e KMFP-së si dhe deputetë nga parlamenti suedez, zyrtarë të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë si dhe zyrtarë nga SIGMA, kanë diskutuar për domosdoshmërinë e rritjes së ndikimit të auditimit në përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike, si dhe përvojat dhe praktikat më të mira nga vendet e Bashkimit Evropian.

Delegacioni nga Parlamenti i Suedisë dhe Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë gjatë qëndrimit në Kosovë janë pritur në takim të veçantë nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z.Glauk Konjufca.

## Fotogaleria 2. Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës



## Foto 2. Takimi me kryetarin e Kuvendit të Kosovës



**Takimet e AP-së dhe marrëveshjet e nënshkuara-** Bashkëpunimi me përfaqësuesit e institucioneve publike të vendit ka vazhduar përmes aktiviteteve dhe takimeve të ndryshme, në të cilat janë prezantuar çështjet kryesore të auditimit për vitin 2021 dhe progresi në zbatimin e rekomandimeve.

Brenda kompetencave institucionale, kujdes i veçantë i është kushtuar bashkëpunimit profesional me Thesarin. Në këtë kuadër është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për transferimin automatik të të dhënave nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Thesari në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Po ashtu, ZKA dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit i cili do të lehtësojë bashkërendimin e aktiviteteve ndër institucionale me qëllim të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës në fushën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të bashkëpunimit të jashtëm, ZKA dhe USAID-i, kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për zbatimin e Projektit “Aktiviteti për Integritet të Komunave të Kosovës”. Përmes këtij Projekti, DAI- USAID do ta mbështesë ZKA-në në zhvillimin dhe forcimin e procesit të auditimit në Kosovë, me fokus të veçantë në: forcimin e operacioneve të Njësisë Kundër Mashtrimit; Forcimin e mekanizmave për llogaridhënie më të madhe për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm; mbështetjen e ZKA-së për punën me Komisionet përkatëse të Kuvendit për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit, etj.

Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, gjatë kësaj periudhe kohore ka mbajtur një seri takimesh, si me të rëndësishmet janë ato me:

- Drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Drejtorin Menaxhues të AKP-së;
- Bordin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Zëvendës Drejtorin e Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje të USAID-it;
- Përfaqësuesit e projektit të DEMOS-it;
- Përfaqësuesit e FMN-së;
- Udhëheqësin e ekipit të Projektit të BE-së për zbatimin e reformës në menaxhimin e financave publike;
- Kryesuesin e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, etj.

Pjesëmarrja e AP-së dhe përfaqësuesve të ZKA-së në konferenca, punëtori dhe aktivitete të ndryshme vendore ka qenë gjithashtu pjesë e agjendave të këtij viti, si:

- Tryezën “Sfidat e komunave në menaxhimin e investimeve, shpenzimeve, të hyrave dhe pronave”;
- Konferencën “Reforma në Administratën Publike në Kosovë: Sfidat, progresi dhe rruga përpara”;
- Aktivitetin “Zhbëjmë paragjykimet, punojmë për gjithë përfshirjen”;
- Tryezën me temën “Luftimi i Korrupsionit në Prokurimin Publik”;
- Dëgjimin publik lidhur me Projektligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore;
- Punëtorinë “Ekzekutimi i Buxhetit nga Organizatat Buxhetore dhe zbatimi i rekomandimeve të dala nga RVA 2021”;
- Aktivitetin “Bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës”;
- Seminarin për integrimin gjinor në proceset e auditimit;
- Ceremoninë e 20-vjetorit të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK)..

## **2 Komunikimi me mediat, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe palë të tjera**

Gjatë vitit 2022, ZKA-ja ka pasur në fokus bashkëpunimin dhe partneritetin me mediat, Organizatat e Shoqërisë Civile, si dhe komunikimin me qytetarë. Ky komunikim është avancuar përmes konferencave, takimeve si dhe aktiviteteve të ndryshme.

ZKA-ja këtë vit ka intensifikuar komunikimin me publikun qysh nga faza e hershme e procesit të auditimit, pra faza e parastudimit të auditimeve të performancës, ku publiku është informuar përmes komunikatave të veçanta për media për secilin auditim, duke përfshirë periudhën kohore, qëllimin, fushëveprimin, si dhe objektivat audituese.

Konferencat për media - AP-ja gjatë vitit 2022 ka mbajtur dy konferenca për shtyp, një lidhur me fillimin e publikimit të raporteve të auditimit, si dhe tjetra për përfundimin e sezonit auditues 2021/2022. Konferenca e parë është mbajtur në muajin maj kur ka

### Foto 3. Konferenca për media



plotëni sezonin auditues 2021/22.

filluar publikimi i raporteve të auditimit, në të cilën janë prezantuar dhjetëra raporte të auditimit, rezultatet e së cilave kanë nxjerrë në pah parregullsitë thelbësore në menaxhimin financiar dhe kontrollet. Ndërsa konferenca e dytë është mbajtur në korrik me rastin e përfundimit të sezonit auditues, ku është bërë me dije se ZKA-ja brenda afatit ligjor ka përfunduar në

Puna dhe rezultatet e auditimit kanë qenë më afër publikut me rritjen e prezencës së ZKA-së në media, duke u botuar më shumë se njëmijë (1000) artikuj për raportet e auditimit dhe aktivitetet e AP-së.

**Bashkëpunimi me OSHC-të dhe Shoqatat Profesionale-** Me qëllim të forcimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat profesionale, Zyra Kombëtare e Auditimit ka mbajtur tryezat “Fuqizimi i bashkëpunimit mes ZKA-së dhe shoqërisë civile për të rritur ndikimin e auditimit në institucionet publike”, si dhe “Prezantimi i planit vjetor të auditimit 2022/2023 dhe përfshirja e shoqërisë civile në fazën e parastudimit”.

ZKA-ja në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit ka mbajtur tryezën me temën “Ujërat, e drejtë e njeriut – mbikëqyrja dhe llogaridhënia”. Në kuadër të tryezës janë paraqitur të gjetura dhe rekomandime të rëndësishme të rezultuar nga raporti i auditimit të performancës “Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre mbi ndikimin në mjedis dhe ujëra” dhe të gjeturat nga Avokati i Popullit lidhur me gjendjen e ujërave në vend, si dhe paraqitja e raportit me rekomandime për hidrocentralet.

Po ashtu, ZKA-ja dhe HELVETAS Swiss Intercooperation në Kosovë/ Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave (DEMOS) kanë mbajtur punëtorinë për vendosjen e mekanizmave mbikëqyrës në qeverisjen lokale për të rritur ndikimin e auditimit, përkatësisht rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

ZKA-ja dhe Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)/Departamenti për Demokratizim, kanë mbajtur punëtorinë për përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit në nivelin e pushtetit lokal.

**Konferenca Vjetore “Plani Strategjik 2023-2026”-** ZKA ka mbajtur Konferencën Vjetore me temën “Plani Strategjik 2023-2026”, ku është prezantuar Plani Strategjik 2023-2026, si dhe është diskutuar për sfidat e mundshme dhe realizimin e planit vjetor të punës 2022/2023. Në kuadër të Konferencës është bërë edhe shpërndarja e jubileve për punonjësit e ZKA-së si dhe falënderimet për ish kolegët që tashmë nuk janë pjesë e Zyrës.

**Vlerësimet për ZKA-në nga palët e jashtme për vitin 2022 - ZKA është vlerësuar më e besuara ndër institucionet e auditimit në rajon sipas Barometrit Ballkanik për**

### Fotogaleria 3 - Konferenca e ZKA-së



vitin 2022. Në kuadër të indikatorit matës për nivelin e besueshmërisë në institucionet publike, rezultojnë se Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës gëzon besimin më të lartë në nivel rajonal. Afërsisht tri të katërtat apo 74% e të anketuarve janë shprehur se i besojnë këtij institucioni krahasuar me 36% sa ka qenë në vitin 2020 sipas këtij Barometri. Ky është niveli më i lartë i besueshmërisë krahasuar me institucionet supreme të auditimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Të dhënat e Barometrit Ballkanik, po ashtu tregojnë se 67% e qytetarëve të Republikës së Kosovës e perceptojnë Zyrën Kombëtare të Auditimit si institucion të pavarur nga ndikimi politik për dallim nga 32% sa ishte në vitin 2020. Barometri i Ballkanit ka vlerësuar perceptimin e qytetarëve në aspektin se sa ZKA ka shqyrtuar punën e Qeverisë për ta mbajtur atë përgjegjëse para qytetarëve. Kosova kryeson edhe në këtë aspekt: 68% e të anketuarve (22% më shumë se në 2020) mendojnë se ZKA-ja është në gjendje të shqyrtojë punën e qeverisë”.

**Raporti i Progresit për Kosovën për 2022-** ka vlerësuar punën dhe rezultatet e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Përveç tjerash është vlerësuar lartë edhe bashkëpunimi i ZKA-së me Kuvendin e Kosovës, përkatësisht shqyrtimi i raporteve të auditimit nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, rritja e numrit të auditimeve të performancës, bashkëpunimi me shoqërinë civile, si dhe qëndrueshmëria e ZKA-së sa i përket kapacitetit të resurseve njerëzore.

Gjatë kësaj periudhe kohore, ZKA-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë vënies në dispozicion të informatave të kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile, mediave dhe qytetarëve si dhe avancimit të komunikimit në rrjetet sociale.

Po ashtu, vlen të theksohet se web faqja e ZKA-së, si burimi kryesor i informacionit është përditësuar në vazhdimësi duke i ofruar qytetarëve qasje në të dhëna për raportet e auditimit. Brenda vitit janë regjistruar mbi 217 mijë vizitorë.

#### Galerija fotografija 4 - Tabela sa OCD



### 3 Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere dhe Marrëveshjet Bilaterale

Si anëtare me të drejta të plota në dy organizatat kryesore të auditimit; INTOSAI dhe EUROSAI, ZKA gjatë vitit 2022 është fokusuar në ruajtjen dhe avancimin e bashkëpunimit me organizatat homologe në rajon dhe më gjerë.

Me 14 dhe 15 mars në Paris i ka zhvilluar punimet Konferenca Ndërkombëtare “E ardhmja e Evropës” e organizuar nga Gjykata Franceze e Llogarive në kuadër të Kryesimit të Këshillit të Bashkimit Evropian nga Franca, ku kanë marrë pjesë krerët e Institucioneve Supreme të Auditimit nga Evropa, përfshirë edhe Auditorin e Përgjithshme, Vlora Spanca me bashkëpunëtor. Në kuadër të konferencës, AP-ja ka takuar Presidentin e Gjykatës Franceze të Llogarive z. Pierre Moskovic dhe homologë të tjerë.

Në kuadër të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidatë dhe kandidatë të mundshme për Bashkimin Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Auditimit, SIGMA ka organizuar në Paris takimimin me kryetarë të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA) për të diskutuar për aktivitetet e fundit të Rrjetit, sfidat në realitetin e ri të krijuar nga Covid-19, si dhe prioritetet për të ardhmen.

Në maj 2022, Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, dhe Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, Beza Halilaj kanë marrë pjesë në post Kongresin e EUROSAI-t që është mbajtur në Pragë. AP-ja ka zhvilluar takime bilaterale me krerë të tjerë të Institucioneve Supreme të Auditimit, si Presidentin e Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës Çeke njëherësh Presidenti i EUROSAI-t Miloslav Kala.

Po ashtu, në nëntor 2022 ZKA për herë të parë ka marrë pjesë si anëtare me të drejta të plota në Kongresin e 24-të të Institucioneve Supreme të Auditimit i organizuar nga Gjykata Federale e Llogarive të Brazilit. Kongresi ka miratuar dokumente të rëndësishme përfshirë edhe rregullat dhe procedurat e organizatës, raporte pune, si dhe Planin Strategjik të INTOSAI-t 2023-2028. Po ashtu janë trajtuar dy tema me rëndësi të veçantë të auditimit publik si: “Roli i institucioneve supreme të auditimit në përballje me katastrofat” dhe “Zëri global, rezultati global dhe ndikimi largpamës”.

**Projekti “Bashkëpunimi për Zhvillim Institucional me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës 2020-2023”.** Edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit bilateral në mes Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Komiteti Drejtues i Projektit në takimimin e rregullt vjetor ka vlerësuar se projekti ka arritur të realizoj në masë të kënaqshme aktivitetet sipas planit vjetor të punës si dhe ka shqyrtuar sfidat e hasura në zbatimin e aktiviteteve gjatë vitit 2022.



Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar aktivitete të shumta sipas komponentëve të projektit, Vlen të përmendet se është zbatuar me sukses pilotimi i instrumentit “Team-Pro”, mjet i cili do t’i ndihmojë ekipet e auditimit dhe njësitë punuese në ZKA të rrisin dhe zhvillojnë raporte të shëndosha ndërkolegiale dhe të nxisin bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet punonjësve.

Gjithashtu janë zhvilluar trajnime, mentorim dhe këshillim në procese të rëndësishme të ZKA-së sikurse, planifikimi, kontrolli i cilësisë dhe sigurimin e cilësisë, shkrimi i raporteve, etj. Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, me bashkëpunëtorë kanë realizuar vizitë pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Qëllimi i vizitës dhe diskutimeve ishte identifikimi i nevojave të ZKA-së për mbështetje dhe planifikimi i aktiviteteve për vitin 2023 në kuadër të këtij projekti.

### Fotogaleria 5. Takime bilaterale dhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare





**EUROSAI Task Force on Municipality Audit Seminar “Digitalization of Public Service Delivery and Administration in Municipalities” and the 6th Annual Meeting of EUROSAI TFMA members**

19–20 October 2022



**Takimet e AP-ve me homologë dhe vizita jashtë vendit-** gjatë kësaj periudhe kohore janë zhvilluar disa vizita jashtë vendit dhe janë realizuar disa takime me homologë të ISA, si;

- AP-ja është pritur në takim nga Auditorja e Suedisë;
- AP-ja ka pritur në takim kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë;
- Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Auditorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Auditimit të Maqedonisë së Veriut për auditimin e fondeve IPA;
- AP-ja ka mbajtur takim virtual me Avokatin e Popullit dhe Auditorin e Përgjithshëm të Izraelit; dhe
- Krerët e Institucioneve Supreme të Auditimit, anëtarë të EUROSAT-t, në të cilin pjesëmarrës ishte edhe Auditorja e Përgjithshme janë pritur në takim nga presidenti i Çekisë.

Në kuadër të këtyre vizitave, AP-ja dhe përfaqësuesit e tjerë të ZKA-së kanë marrë pjesë edhe në konferenca dhe punëtori rajonale e ndërkombëtare, si:

- Konferencën ndërkombëtare “E ardhmja e Evropës” pas krizës shëndetësore Covid-19;
- Konferencën rajonale “Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit”;
- Takimin e presidentëve të Institucioneve Supreme të Auditimit;
- Konferencën Rajonale për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor “Financimi transformues si një përshpejtues për barazinë gjinore: duke marrë përvojat dhe mësimet e nxjerra nga buxheti i përgjegjshëm gjinor”;
- Konferencën “Young EUROSAT Stockholm 2022”;
- Konferencën Rajonale të Autoriteteve të Auditimit për fondet e IPA-s;
- Seminarin “Digjitalizimi i ofrimit dhe administrimit të shërbimeve publike në komuna”;
- Përfaqësuesit e ZKA-së kanë zhvilluar vizitën studimore në Suedi nën organizimin e UN Women.

Gjatë vitit 2022, ZKA-ja është anëtarësuar në Task Forcën e EUROSAT-t për auditimin e komunave, është bërë pjesë e Grupit Punues të EUROSAT-t për Teknologji të Informacionit, si dhe Projekt Grupin e EUROSAT për bashkëpunimin e ISA-ve me partnerët (hisedarët). Në kuadër të bashkëpunimit regjional Auditorja e Përgjithshme ka miratuar Planin e


Punës së Rrjetit 2023/2025.


Duhet të potencohet që ZKA-ja ka kryer me kohë dhe relevancë të gjitha raportimet lidhur me Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe Strategjisë për Reformën në Menaxhimin e Financave Publike, si dhe të gjitha obligimet tjera që lidhen me integrimin evropian.

# 5

## Kapitulli

Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2023





## Kapitulli V – Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2023

### 1 Llogaridhënia e ZKA-së

Pasqyrat Vjetore Financiare të ZKA-së janë dorëzuar dhe janë përfshirë në raportin e Qeverisë për Buxhetin e Kosovës për vitin 2022 në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Kuvendi i Kosovës ka kontraktuar një kompani audituese për auditimin e PVF të ZKA-së, dhe në këtë Raport janë përfshirë Pasqyrat Vjetore Financiare të audituara si dhe opinioni i dhënë nga auditorët e jashtëm të pavarur.

ZKA-ja në kuptim të raportimit financiar dhe performancës, është llogaridhënëse sipas nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

### 2 Aktivitetet gjatë vitit 2023

Zyra Kombëtare e Auditimit ka aprovuar Planin e ri Strategjik për periudhën 2023-2026, i cili trason rrugëtimin e institucionit për 3 vitet e ardhshme. Çdo fushë, qëllim, objektive dhe aktivitet është përzgjedhur me kujdes të veçantë dhe gjithmonë duke pas parasysh shkallën e zbatimit dhe ngecjet e identifikuara në planet e kaluara. Gjatë këtij viti do të intensifikohen veprimet për zbatimin e planit të ri strategjik me qëllim të avancimit të mëtutjeshëm të profesionalizmit në punën auditues në përputhje me qëllimet e planifikuara.

ZKA-ja është anëtarësuar me të drejta të plota në INTOSAI dhe EUROSAT-t dhe gjatë viteve në vijim aspirojmë anëtarësimin në komisionet profesionale dhe në Task Forca të ndryshme në kuadër të tyre.

Gjatë vitit 2023 do të orientohem në aktivitetet si në vijim:

#### Qëllimi 1: Pavarësia, Standardet dhe Cilësia

- ✓ Procedimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore, në harmoni të plotë me INTOSAI P-10 që do të mundësonte aplikimin e metodologjisë për përzgjedhjen e auditimeve bazuar në rrezik;
- ✓ Përcjellja e standardeve të INTOSAI-t dhe përditësimi i doracakeve auditues dhe udhëzueseve në pajtim me SNISA-t;
- ✓ Zhvillimin e arkives digjitale, si dhe proceset e ndryshim/plotësimit të rregulloreve të brendshme në frymën e legjislacionit në fuqi;
- ✓ Rritja e vazhdueshme numrit të auditimeve të pajtueshmërisë dhe të performancës që do të rezultojnë me ndikimin e auditimeve në qeverisjen e mirë dhe mirëqenien e qytetarëve.

## Qëllimi 2: Kapacitetet dhe Burimet

- ✓ Avancimi i menaxhimit të burimeve njerëzore me fokus funksionalizimi i sistemit elektronik (digjitalizimi) për menaxhimin e burimeve njerëzore në ZKA;
- ✓ Avancimi dhe zhvillim profesional, bazuar në vlerësimin e rezultateve të punës për gjithë stafin për zbatimin e objektivave strategjike;
- ✓ Forcimi i mëtejshëm i kontrolleve të brendshme institucionale;
- ✓ Fuqizimin e shërbimeve financiare dhe njerëzore.

## Qëllimi 3: Imazhi dhe Ndikimi

- ✓ Bashkëpunimi me OB për zbatimin e rekomandimeve dhe publikimi i bazës së të dhënave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
- ✓ Komunikimi i rregullt me komisionet parlamentare, palët e jashtme, shoqërinë civile dhe mediat;
- ✓ Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e organizatave profesionale të auditimit INTOSAI dhe EUROSAL.



## Shtojca I. AUDITIMET PËR SEZONIN 2021/22 DHE 2022/23

Në sezonin e auditimit 2021/2022 janë publikuar **134 raporte** të auditimit, si në vijim:

### **116 raporte të auditimit financiar me pajtueshmëri:**

- Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës, të vitit 2021,
- 52 Institucione të Nivelit Qendror,
- 38 Komuna,

### **12 Ndërmarrje Publike:**

- ✓ Telekom i Kosovës sh.a,
- ✓ Posta e Kosovës sh.a,
- ✓ Ndërmarrja Publike Banesore-Prishtinë,
- ✓ Trainkos sh.a,
- ✓ Hekurudhat e Kosovës -Infrakos sh.a,
- ✓ KRU Prishtina sh.a,
- ✓ NPH „Ibër-Lepenc” sh.a,
- ✓ KRU Hidroregjioni Jugor sh.a,
- ✓ KRU Hidromorava ,
- ✓ KRM „Uniteti” sh.a-Mitrovicë,
- ✓ KRM Pastrimi sh.a, dhe,
- ✓ Ndërmarrja Publike „Termoskos” sh.a -Prishtinë.

### **13 projekte të financuara nga donatorët:**

- ✓ Zhvillimi rural dhe agrobujqësor (MBPZHR-BB),
- ✓ Ekonomia Digjitale në Kosovë (MEA-BB),
- ✓ Projekti për Përmirësimin e Sistemit Edukativ të Kosovës (MASHT-BB),
- ✓ Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH-BB),

- ✓ Eficienca e energjisë së ripërtëritshme (MZHE-BB),
- ✓ Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksportim (MTI-BB),
- ✓ Programi Mjedisor i Kosovës, PMK 2016-2020 (MMPH-SIDA),
- ✓ Përkrahja për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë (ZKM-SIDA)
- ✓ Projekti i emergjencës COVID-19 në Kosovë (MSH-BB),
- ✓ Financimi i emergjencës pandemike në Kosovë (MSH-BB),
- ✓ Projekti i emergjencës COVID-19 në Kosovë (MPMS-BB),
- ✓ Pasuria e paluajtshme dhe infrastruktura gjeo-hapësinore (Agjencia Kadas-trale e Kosovës), dhe
- ✓ Projekti “Komunat për rininë në Kosovë” (MAPL-BB).

### 15 auditime të performancës

- ✓ Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre mbi ndikimin në mjedis dhe ujëra,
- ✓ Menaxhimi i fondeve publike Radio Televizioni i Kosovës,
- ✓ Vlerësimi i nxënësve në testet kombëtare dhe ndërkombëtare,
- ✓ Furnizimi me barna dhe materiale shëndetësore për t’iu përgjigjur nevojave të pacientëve me Covid-19,
- ✓ Optimizimi i resurseve njerëzore dhe pajisjeve teknike mjekësore për t’iu përgjigjur nevojave të pacientëve me Covid-19,
- ✓ Vendimmarrjet lidhur me strukturën organizative dhe Alpex- dega në Kosovë-KOSTT
- ✓ Prokurimet e KEK-ut (2018-2020),
- ✓ Kontratat e centralizuar -Shërbimet e transportit ajror,
- ✓ Menaxhimi i projektit „Bashkimi i Qytetit Ferizaj”,
- ✓ Projektet e menaxhuar grantet e DEMOS,
- ✓ Projektet kapitale të KOSTT (2015-2021),
- ✓ Sistemi informativ i gjendjes civile në ARC,
- ✓ Sistemi për menaxhimin e pagave - PAYROLL,
- ✓ Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve për SIMFK në pjesën e TI-së, dhe
- ✓ Performanca financiare dhe operative e NP „Trepça”.

### 3 Auditime të pajtueshmërisë

- ✓ Dhënia e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronës dhe marrëveshjeve për blerje të energjisë –KOSTT-Kuvendi i Kosovës, dhe
- ✓ Informatat e klasifikuara „ E KUFIZUAR”- Ministria e Mbrojtjes.

#### Plani vjetor për sezonin e auditimit 2022/23,

Ky Plan ka filluar në shtator të vitit 2022, ZKA planifikon të përfundojë 134 raporte të auditimit, si në vijim:

- ❖ **113 raporte të auditimit financiare dhe pajtueshmërisë:**
  - Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2022
  - 52 Institucione të Nivelit Qendror, dhe
  - 38 Komuna,

#### 11 Ndërmarrje publike:

- ✓ Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a (KEK),
- ✓ Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a,
- ✓ Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, sh.a,
- ✓ KRU “Prishtina” sh.a - Prishtinë,
- ✓ Ndërmarrja Publike Banesore - Prishtinë,
- ✓ Telekom i Kosovës,
- ✓ Posta e Kosovës,
- ✓ KRM “Pastrimi”, sh. a - Prishtinë,
- ✓ KRM “ Uniteti” sh.a - Mitrovicë,
- ✓ Ngrohtorja Qendrore “Termokos” – Prishtinë, dhe
- ✓ NPH “Ibër - Lepenc” sh.a – Prishtinë.

## 11 Projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët

- ✓ Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksport (MTI - BB),
- ✓ Eficienca e Energjisë së ripërtëritshme-konsolidim (MZHE - BB),
- ✓ Zhvillimi Rural dhe Agrobujqësor (MBPZHR - BB),
- ✓ Ekonomia Digjitale në Kosovë (MEA – BB),
- ✓ Projekti i emergjencës Covid-19 në Kosovë (MSH - BB),
- ✓ Pasuria e paluajtshme & infrastruktura gjeo-hapësinore (Agjencia Kadastrale e Kosovës - BB),
- ✓ Projekti “Komunat për rininë në Kosovë” (MPL – BB),
- ✓ Programi Mjedisor i Kosovës (MMPH - SIDA),
- ✓ Projekti „Reforma në Sistemin e Asistencës Sociale” (2 projekte-BB),
- ✓ Projekti „ Prog. Shfrytëzimi dhe nxitja e mundësive për sigurinë e ujit”(BB), dhe
- ✓ Projekti „ Prog. Shfrytëzimi dhe nxitja e mundësive për sigurinë e ujit”(BB)

## 18 Temat e auditimeve të performancës:

- ✓ Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje,
- ✓ Lista e pritjes së pacienteve në ISHP,
- ✓ Procesi i Akreditimit të Institucioneve të Larta Arsimore,
- ✓ Ndikimi investimeve kapitale në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe përmirësimin e shërbimeve në KRU,
- ✓ Menaxhimi i licencimeve ne Komisionin e Pavarur për Media,
- ✓ Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme-MTI/KIESA,
- ✓ Efektiviteti i fondeve për sponsorizimin e sportit,
- ✓ Kontratat e lidhura me procedure të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë/ MMPHI,
- ✓ Rinovimi dhe ri konfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilanit dhe Gjakovës
- ✓ Efektiviteti dhe ekonomia në ndërtimin e shtëpive për të kthyerit (riatdhësimi),

- ✓ Projektet e financuara nga grantet e DEMOS për vitin 2021,
- ✓ Kontratat e institucioneve publike të Republikës së Kosovës me organizatën Caritas Kosova,
- ✓ Auditimi përcjellës i zbatimit të rekomandimeve,
- ✓ Performanca financiare dhe operative e Trepçës,
- ✓ Sistemet e informacionit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit MPB,
- ✓ Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjetës Rajonal /Prishtina,
- ✓ E-prokurimi, dhe
- ✓ Menaxhimi i sistemeve të informacionit në Institutin Bujqësor të Kosovës /MB-PZHR.

### **3 Auditim pajtueshmërisë/kërkesë**

- ✓ Të hyrat nga qiraja në Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
- ✓ Informatat e klasifikuara „ E KUFIZUAR” - Ministria e Mbrojtjes,
- ✓ Informatat e klasifikuara „ E KUFIZUAR” -Ministria e Drejtësisë,

## Shtojca II. PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZKA-SË PËR VITIN 2022

**Pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit të pavarur**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	3
Neni 12. Deklarata për prezentimin e pasqyrave financiare	5
Neni 13. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme	6
Neni 14. Raporti i ekzekutimit të buxhetit	7
Neni 15. Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare	8
Neni 14.6 Shpalojsja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit	10
Neni 16 Raport për të arkëtueshmet	20
Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara	20
Neni 18 Detyrimet kontingjente	22
Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare	27
Neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara	24
Neni 24 Raport për fondet e donatoreve të pashpenzuara	24
Neni 25. Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave	25
Neni 26. Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave	25
Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontratë për shërbime të veçanta	25
Neni 28 Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet për Zyrën Kombëtare të Auditimit për vitin paraprak	26



## Raporti i Auditorit të Pavarur

**Për: Auditorin e Përgjithshëm**

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (më tej referuar si "Organizata" ose "ZKA"), që përfshinë Pasqyrën e Pranimit të Parave dhe Pagesave dhe Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022, dhe shënimet e pasqyrave financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2022, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme.

### *Baza për opinion*

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin: Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare në raportin tonë. Ne jemi të pavarur nga ZKA në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët Profesionist (KodiBSNEK) së bashku me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të ZKA-së në Republikën e Kosovës dhe ne kemi përmbushur përgjegjësi të tjera etike në përputhje me Kodin e BSNEK-së. Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë janë të njafueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

### *Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave financiare nëpërputhje me udhëzimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 03 L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin Nr. 041/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar ngaligjet Nr. 03/L-221 dhe Nr. 04/L-116 të cilët përcaktojnë që pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme dhe për kontrollin e brendshme siç përcakton menaxhmenti, është e nevojshme të mundësojë përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomalitë materiale, qoftë si pasojë e mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e parimit të vijimësisë së ZKA-së, shpalosjet, zbatueshmërinë, çështjet e ndërlidhura me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimësisë në kontabilitet përpos nëse menaxhmenti dëshiron të likuidojë ZKA-në, ndërprejë operacionet ose nuk ka alternative reale por ta bëjë këtë veprim.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ZKA-së



***Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare***

Objektivat tona janë ofrimi i sigurisë së arsyeshme në lidhje me çështjen se a janë pasqyrat financiare të liruara nga gabimet materiale si rezultat i mashtrimit apo gabimit dhe lëshimi i një raporti të auditorit që përmbanë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit do tëzbulojnë gabimet materiale nëse ato egzistojnë. Gabimet mund të ndodhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse individualisht apo në tërësi pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve që bazohen në këto pasqyra financiare.

